



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.2(451)

SHKURT 2026

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtore: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

106 VJETORI

KONGRESI I LUSHNJËS JANAR 1920 DHE ROLI I KONSULLIT BRITANIK MORTON FREDERIK EDEN



Nga Sakip Cami

FAQE 9

IN MEMORIAM

ANASTASIA (CIA) MANDRO, VLONJATJA E HEKURT ANTIFASHISTE



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 8

EMERGJENCAT CIVILE

MINISTRI VENÇU: MBËSHETJE KONKRETE PËR KOMUNITETET NË RASTE EMERGJENCASH



FAQE 16

KRYESIA E OBVLP VLERËSON ME TITULLIN E ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE VETERANËT E LANÇ GENC BALLANCA DHE RIZA LIKA

TATJANA PARLLAKU-ÇARKAXHIU: NDERIM DHE RESPEKT PËR LUFTËTARËT E LIRISË

OPINION

SHBA NUK E PUSHTUAN POR E ÇLIRUAN VENEZUELËN NGA MADURO/T?!

Gjeneral © PIRO AHMETAJ FAQE 2

REFLEKSIONE

LIBRI I PROF. DR. IRAKLI KOÇOLLARIT "OPERACIONE SEKRETE"

SHPENDI TOPOLLAJ FAQE 12

OPINION

KUR KARAKTERI TEJKALON PUSHTETIN

Dr. Evarist Beqiri FAQE 13

PERSONAZH

SALI DUKA, ANTIFASHISTISI, EMBLEMË E DISIDENCËS

Halil Rama - Mjeshtër i Madh FAQE 10

POEZI NGA AGIM BAJRAMI FAQE 14



• *"Ne krenohemi me këta personalitete që aderojnë dhe i japin jetë organizatës tonë, duke punuar me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Ata dhe shumë pasardhës të tjerë të veteranëve, anëtarë të OBVLP, me shembullin e tyre, frymëzojnë brezat e rinj të rriten me dashurinë për vendin, për paqen dhe për njeriun"* FAQE 3

KULTURE

TRASHEGIMIA KULTURORE E MUHURRIT DHE ANSAMBLI "DINA DODA"

Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

Brenda tre viteve është shndërruar në promovuesin e vlerave më të mira të kulturës sonë kombëtare



FAQE 15

HISTORIA

83 VJET MË PARË, OPERACIONI I MADH ARMIK I DIMRIT 1943-1944

FAQE 4

82-VJETORI

NGA BUJANI TE VERIU I KOSOVËS: NJË HISTORI E MOHUAR DHE E PËRSËRITUR

Nga Bashkim Hisari FAQE 5

HISTORIA

RAMICA - BAZË E LANÇ-IT NË QARKUN E VLORËS

Prof. asoc. Bernard ZOTAJ - Mjeshtër i Madh FAQE 11

FJALA

TRADITA E ARSIMIMIT NË SHKOLLËN 100-VJEÇARE "AHMET CAMI" TË GJORICËS

Nga Tefta Cami FAQE 6

PROFILI

BESLIM ELEZ HOXHA, PERSONALITET I SHQUAR I ARSIMIT SHQIPTAR

Nga Xhemal Meçi Mjeshtër i Madh FAQE 7

OPINION

Pse ShBA nuk e pushtuan por e çliruan Venezuelën nga Maduro/t?!

Gjeneral © Piro Ahmetaj*

Siç është e mirënjohur, më 3 janar 2026, pra ende pa kapërdijë (për humor) kaposhin e detit dhe as urimet tradicionale, Presidenti Donald Trump urdhëroi përdorimin e fuqisë ushtarake për të prangosur dhe çuar para drejtësisë z. Nicolas Maduro, i cili: “duke shpërdoruar fuqinë e pushtetit dhe bandave të drogës jo vetëm sundonte prej 13 vitesh popullin e Venezuelës por edhe kërcënonte standardet e jetës dhe sigurisë së amerikanëve, si dhe interesat gjeopolitike në kufijtë jugorë të SHBA-ve”!

I. Përmbledhje mbi gjetjet dhe peshën gjeo-politike nga operacioni për prangosjen e Maduros:

Pikësëpari, përtej makinerisë helmuese të dezinformimit (deep fake), tmerrit së putinistëve, Kim-Joung-ëve ose sundimtarëve të ngjashëm me Maduron, si dhe kakofonisë së të gjithëditurve kudo në studio/media, fatkeqësisht edhe në Tiranë, Prishtinë etj, këtë operacion: “nuk e gjej kurrësesi agresion për pushtimin e Venezuelës”, por si kontribut për çlirimin e saj, si dhe forcimin e besimit të doktrina/qa-sja e fortë e Trump: “paqe e imponuar nëpërmjet forcës, ndaj sundimtarëve të marrë nga fuqia e mbi-pushtetit”!

Po ashtu, edhe Presidentin Trump e gjej tërësisht brenda ushtrimit të përgjegjësive kushtetuese të shpallura në Strategjinë e Sigurisë - 2025 (e miratuar në Kongres dhe Senat) e cila përfshin: “detyrën e FAA për mbrojtjen e kufijve shtetërorë, standardeve të sigurisë së qytetarëve si dhe interesave amerikane nga armët e shkatërrimit në masë, emigracioni i paligjshëm, narko-terrorizmi ndërkombëtar, etj”. Thënë këtë, pa asnjë dyshim, “prangosja e Maduros pa lejen e Moskës, etj”, vulosi projektin e Presidentit Trump-2 për: “Amerikën edhe më të madhe/fortë, si dhe imponimin e paqes nëpërmjet forcës”, çka legjitimon përdorimin e fuqisë ushtarake ndaj autokratëve të gjithpushtetshëm, të cilët, përveç sundimit të popujve të tyre, kërcënojnë edhe sovranitetin si dhe mënyrën e jetesës së popullit amerikan!

Së dyti, jo vetëm që nuk kishte/ska pushtim nga ShBA-të, por në realitet ky sulm sapo ka ndezur shkëndijën e lirisë për popullin e Venezuelës, Kolumbisë, Kubës, Iranit etj, si dhe shpresës për t'u çliruar nga droga, krimi dhe sundimtarët e gjithpushtetshëm! Prandaj, vetëm disa orë pas prangosjes së Maduros, ShBA-të paralajmëruan edhe Presidentin qesharak kolumbian Gustavo Petro të “mos marrë kot armët”, pasi ka zero mundësi të përballet me ShBA-të në raste të ngjashme.

Përdorimi i forcës ushtarake nuk erdhi brenda një dite. Kjo pasi marrëdhëniet SHBA-Venezuelë u përkeqësuan veçanërisht pasi Maduro mori pushtetin në vitin 2013 (sipas OKB-së janë ekzekutuar pa gjyq mbi 20.000 qytetarë); edhe pse zgjedhjet e korrikut 2024 nuk u njohën nga ShBA-të dhe BE-ja, qëndroi dhe e zgjati pushtetin de-



risa u prangos në rezidencën e tij, duke shpërdoruar fuqinë e shtetit, si dhe duke e kthyer vendin në parajsë të bandave të drogës, si dhe interesave ruse, iraniane, kineze etj. Megjithatë, pas operacionit, ShBA-të konfirmuan se: “do të bashkëpunojnë me një qeveri që do të dalë nga një koalicion gjithëpërfshirës, përfshirë faktorët e moderuar, opozitën zyrtare, si dhe diasporën e Venezuelës, për t'i hapur rrugë zgjedhjeve demokratike dhe stabilitetit të vendit”.

Së treti, jo që nuk është kurrësesi pushtim, por dhe nuk ka “asnjë thyerje të ligjit ndërkombëtar dhe as ka si të jetë një precedent i rrezikshëm”, pasi ShBA-të kurrë nuk kanë synuar dhe as kanë shpallur, pushtim të tërësisë territoriale të Venezuelës. Në të kundërt, e kanë theksuar fort se: “nuk janë në luftë me Venezuelën, por me sundimtarët e atyre që zbrazin burgjet dhe dërgojnë të varurit/sëmuret mendore nga droga drejt ShBA-së, duke kërcënuar jetën e amerikanëve dhe interesat gjeopolitike të ShBA-së”, qofshin në Venezuelë, Kolumbi, Kubë, Iran e kudoqofshin!

Për më tepër, nuk gjej asnjë krahasim me agresionin neo-nazist të Rusisë putiniste rreth 4 vjet më parë, e cila synonte jo vetëm pushtimin e Ukrainës, por edhe rendin global, vlerat demokratike, interesat dhe fuqinë ushtarake të Aleancës Euroatlantike (USA/NATO/BE). Kështu ndërsa në fushëbetejën për/me Ukrainën janë vranë dhe plagosur rëndë mbi 1.5 milion ushtarë rusë dhe qytetarë të pafajshëm, në këtë rast, pra në më pak se 5 orë operacion për prangosjen e sundimtarit, forcat ushtarake të ShBA-së vranë personelin e të sigurisë së sundimtarit (- 100), pra nuk u sulmua me raketa dhe dronë vrasës, etj asnjë spital, shkollë, qëndër banimi dhe infrastrukturë jetike për jetën e qytetarëve venezuelas.

Së katërti, prangosja e Maduros kurrësesi nuk mund të definohet si pushtim, edhe pse sigurisht vulosi me forcën e armëve fundin e rendit të vjetër të sigurisë (KS/OKB), si dhe konfirmoi de-

facto themelimin e një rendi të ri, i cili mund edhe të identifikohet me emrin e Donald Trump. Gjithësesi duhet thënë se rendi i vjetër ra edhe për shkak të pak sukseseve, por shumë dështimeve, prej pafuqisë kritike të rendit të vendosur në 1945. Për ta ilustruar këtë mjaftojmë ulërimat e gjenocidi Serbenicës, kur 8000 fëmijë, gra dhe pleq u ekzekutuan barbarisht “para syve të kaskaveBlu të OKB-së” nga makineria kriminale e Millosheviçit!

Së pesti/fundmi, në operacionin “Absolute Resolve”, mbi 150 avionë, përfshirë dronë u nisën nga 20 baza ushtarake, zgjati vetëm 4:45’ dhe pati zero humbje, duke nxjerrë tërësisht jashtë luftimi sistemin e mbrojtjes ajrore të një vendi që shpenzon mbi 6 miliardë \$ në vit për mbrojtjen, çka denostroi jo vetëm një nga operacionet “më diskret, më të shpejt, më preciz dhe më të suksesshëm që ka ndërmarrë ndonjëherë fuqia ushtarake e ShBA-ve”. Nga ana tjetër, pafuqia reaguese (zero) e Venezuelës ngre edhe disa pikëpyetje kritike për aftësitë/efiçencën operacionale të sistemeve dhe armatimeve të mbrojtjes ajrore të prokuruar/blera nga Kina dhe Rusia, pasoja që do të reflektohen në vijimësi nga çdo vend ?!

Në përmbledhje, asnjë shtet tjetër botë (përfshi Kinën dhe Rusinë) nuk ka dhe nuk ka për të patur në 100 vitet që vijnë, fuqi ushtarake për të realizuar operacione të përafërta me këto 2 raste (përfshi sulmin me 6 avionë B-2 me kosto 2-bilion \$; 37 orë fluturim; 10-ra raketa Tomahawk dhe 125 avionë F-35 ndaj bazave bërthamore të Ajatollah-ut të Iranit) shërbejnë edhe si mesazh i fuqisë shkatërrimtare të USA ndaj Putinit, Kim Jong, etj, nëse guxojnë të kërcënojnë interesat amerikane apo këdo nga 32 vendet anëtare të NATO-s.

II. MËSIMET DHE KËSHILLA STRATEGJIKE PËR RSH DHE KOSOVËN:

1) Ndërsa përveçse fantazi delekuentësh, nuk gjej asnjë krahasim mes rastit Maduro dhe RSh dhe asnjë

vendi tjetër të NATO-s, por përtej kësaj krize hibride, pra: “demokracia fasadë dhe opozit e refuzuar/diskredituar nga riciklimi i listave të neveritura në 4 zgjedhjet e fundit si dhe shtetit të dështuar/lapur nga korrupsioni endemic”, rikthimin e besimit të demokracia funksionale dhe harmonia e balancave të pushtetit, mbetet jo vetëm këshilla nr. 1, por dhe sfida dhe misioni jetik i mbarë-shqiptarëve.

2) Marrë shkak po nga rasti Maduro si dhe shkatërrimi i bazave bërthamore të Iranit, më duhet ta përsëris se në një Rend të Ri Sigurisë Globale (vulosur tashmë me emrin e Presidentit Trump), asnjë vend nuk e përballon dhe as i mbijeton dot i vetëm një agresioni ushtarak. Thënë këtë, mbrojtjen e sovranitetit, si dhe zhvillimin e interesave gjeopolitike, RSh dhe Kosova, do mund t'i realizojnë vetëm duke skalitur mirënjohjen kombëtare, si dhe duke forcuar më tej bashkëpunimin strategjik me ShBA/NATO.

3) Përtej oshilacioneve të Vuçiç-it, por duke ri-duartrokitur “marrëveshjen mes Kroacisë, Kosovës dhe RSh, si dhe Buxhetin Historik të Mbrojtjes 2026”, faktorët shtetërorë në Tiranë dhe Prishtinë do t'i këshilloja të përuhlen/mi në gjunjë para historisë së përgjakshme për t'i dhënë jetë Platformës: “2-Shtete sovraane, 1-Komb i Vetëm”, e cila do të kontribuojë për paqen, stabilitetin si dhe integrimin euroatlantik të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Po ashtu, konsideruar mësimin e hidhur nga gjysmimi që u imponua “Shqipërisë Natyrale” nga pafuqia ushtarake në Konferencën e Versajës (1918), këtë projekt e gjej jo vetëm si urgjencë Kombëtare, por fatmirësisht edhe të ndërthurur me interesat e SHBA-së në rajon dhe Mesdhe.

4) Ndërsa ri-kthimin te gara e armatimeve në Ballkanin Perëndimor dhe armatosjen deri në dhëmbë të Serbisë, objektivin e RSh drejt 5% të GDP-së (rreth 1.5 miliardë €), përveçse si “presion” të Presidentit Trump, e gjej edhe si legjitimitet ndërkombëtar (ShBA/NATO/BE), por edhe mundësi historike për të modernizuar dhe rritur fuqinë ushtarake, përfshi kapacitete deterrence (pra shkurajuese) ndaj çdo vendi/aleance Ruso-sllave që kërcënon sovranitetin apo interesat gjeopolitike të RSh dhe Kosovës.

Së fundmi, si edhe në qindra produkte me këtë subjekt, të publikuara në Tiranë, Prishtinë, ShBA, Bruksel etj, nuk pretendoj të privatizoj të vërtetat shteruese, gjithësesi shpresoj të kontribuojnë në mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave gjeopolitike si dhe ardhmërinë euroatlantike të Kombit (Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës).

* Autori: Gjeneral © Piro Ahmetaj; Senior Ekspert për Sigurinë dhe Mbrojtjen Kombëtare, Ballkanit si dhe marrëdhëniet me USA/NATO.

AKTUALITET

KRYESIA E OBVLP VLERËSON ME TITUJ NDERI E ÇERTIFIKATË MIRËNJOHJE VETERANËT E LANÇ GENC BALLANCA DHE RIZA LIKA

TATJANA PARLLAKU-ÇARKAXHIU: NDERIM DHE RESPEKT PËR LUFTËTARËT E LIRISË

- *“Ne krenohemi me këta personalitete që aderojnë dhe i japin jetë organizatës tonë, duke punuar me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Ata dhe shumë pasardhës të tjerë të veteranëve, anëtarë të OBVLP, me shembullin e tyre, frymëzojnë brezat e rinj të rriten me dashurinë për vendin, për paqen dhe për njeriun”*



Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve e mbylli kalendarin e veprimtarive të vitit 2025 me dy veprimtari mbresëlënëse.

Paraditen e 16 dhjetorit 2025, Kryetarja e OBVLP Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, Sekretari i Përgjithshëm Halil Rama dhe anëtarët e kryesisë së organizatës Skënder Murrja e Ilirjan Çarkaxhiu, ishin në takim festiv të Kryesisë së Degës Durrës me kryetarin e mirënjohur Shpendi Topollaj.

Në këtë takim të organizuar në nderim të veteranit 97 - vjeçar Genc Ballanca, ku merrnin pjesë gjithashtu edhe nënkryetari i Degës së OBVLP Durrës Kadri Tarelli dhe anëtarët e kryesisë së kësaj dege Agim Bajrami dhe Bajram Sulejmani, Znj. Parllaku i akordoi veteranit Ballanca titullin “Nderi i OBVLP” me motivacionin: “Për kontributin me armë në dorë në luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare si efektiv i Brigadës së IV-t S dhe për drejtimin me përkushtim për dy dekada të degës së OBVLP Durrës”.

Ndër të tjera kryetarja e OBVLP tha se “nderojmë sot veteranin Genc Ballanca që luftoi me armë në dorë me zjarrin e një djaloshi kundër pushtuesve fashistë e nazistë. Gencin, si dhe bashkëluftarët e tij Ne i nderojmë e respektojmë si thesare të çmuara të kombit tonë, duke u kujdesur për jetën dhe veprën e tyre. Ai është pinjoll i një familjeje të nderuar e të çmuar, që ka dhënë kontribute të mëdha në historinë e kombit tonë”.

I lindur në 7 Mars të vitit 1929. Genci ishte djali i një familje të njohur për atdhetari me origjinë nga Dibra e Madhe. Babai i tij Xhevdet Ballanca, ka qenë oficer, që kishte studiuar në Akademitë Ushtarake të Romës e Stambollit, dhe gjithë aftësitë e tij i vuri në shërbim të popullit dhe Atdheut. Duke qenë antifashist, ai përkrahu dhe u lidh me figura të shquara të historisë tonë si Abaz Kupi, Nako Spiru, Iliaz Reka etj. Ai i priti me armë në dorë pushtuesi italianë më 7 Prill të vitit 1939 dhe vazhdoi luftën me forcat nacionaliste. Janë këto vlera, për të cilat ky atdhetar i shquar është dekoruar me rastin e 45 vjetorit të ndarjes nga jeta, nga Presidenti i Republikës, për veprimtari patriotike dhe është shpallur “Qytetar Nderi” i Durrësit me vendimin e datës 20.03.2011. Gjyshi i Gencit, Baftjari është ai që vrau një ditë pazari Mehmet Pashën. Nëna e tij vinte nga familja e njohur atdhetare e Dollive në Kavajë dhe me Xhevdetin patën tetë fëmijë të mrekullueshëm.

I rritur në një mjedis të tillë, edhe Genci, sido që mjaft i ri dhe ende pa e përfunduar plotësisht shkollën e mesme por me ide të qarta për lirinë, u rreshtua me shokët partizanë; fillimisht në Grupin e II - të të Çetës

së Pezës, ku më pas, falë guximit dhe trimërisë së treguar në luftime ju ngarkua detyra e Përgjegjës të Rinisë të batalionit, dhe në vazhdim, porsa u formua Brigada e IV - të Sulmuese, ju besua detyra e zëvendës intendentit të saj.

I mençur dhe me inisiativë, ai kudo që u caktua i kreu detyrat e ngarkuara me nder. U shqua në luftimet e zhvilluara deri në largimin e plotë të armikut dhe pas çlirimit të vendit u emërua në Komandën e Përgjithshme, ku pa nga afër përpjekjet e pareshtura për rritjen, fuqizimin dhe modernizimin e ushtrisë tonë. Por në vitin 1948, duke parë nevojën që kishte për të familja e tij, ai vendos të kthehet në qytetin e Durrësit ku kryen detyra të ndryshme dhe të rëndësishme në ndërmarrje të sapokrijuara.

Kudo që punoi u dallua për marrëdhënie korrekte me vartësit dhe shokët, për përkushtim e thjeshtësi, gjë që edhe pasi doli në pension i dha të drejtën të nderohet e respektohet nga të gjithë. Këtë e tregojnë më së miri edhe dekoratat e shumta që i janë akorduar ndër vite.

Duke i mbetur besnik idealeve të pastra, duke mos u pajtuar për asnjë çast me krimet e kryera nga Partia - shtet dhe duke parë se në çfarë mjerimi e varfërie po e çonin Shqipërinë sllonganet demagogjike, ai si kuadër me vizion perëndimor, përkrahu nga të parët lëvizjen demokratike, dhe së bashku me shokë të tjerë, si gjeneral Ernest Jakova, Zenel Bardhi, Idriz Hoxha, Eqrem Kuka, Osman Xhindoli etj. u bashkuan me organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ - OBVL dhe për një kohë të gjatë, kreu me sukses të plotë, detyrën e Kryetarit të Degës për Durrësin, ku u tregua i pa lodhur dhe përherë i përkushtuar. Dega e OBVL - së në Durrës, nën drejtimin e tij u dallua për organizimin e shumë veprimtarive dhe shtimin e radhëve të saj. Edhe tani në moshë të shtyrë, Genc Ballanca vazhdon të interesohet pareshtur për mbarëvajtjen e shoqatës. Kryesia e OBVL i uron atij jetë të gjatë dhe të lumtur me familjen e tij të shtrenjtë.

Për nderimin që i bënte Gencit, e bija e tij Xhixhi dhe vallai Bajrami falenderuan për zemërsisht kryetaren e OBVLP Tatjana Parllaku - Çarkaxhiu, Sekretarin e Përgjithshëm Halil Rama, anëtarët e kryesisë së organizatës Skënder Murrja e Ilirjan Çarkaxhiu si dhe drejtuesit e degës Durrës të kësaj organizate dhe shtruan për ta një koktejl të pasur në një nga lokalet pranë zyrës së degës OBVLP Durrës.

Vetëm pas ditë pas kësaj ceremonie mbresëlënëse në Durrës, kryesia e OBVLP, në takim festiv të fundvitit 2025 nderoi me Çertifikatë Mirënjohje veteranin e LANÇ Riza Sherif Lika, ish partizanin trim të

inkuadruar fillimisht në Çetën e Bulticës dhe më pas në Brigadën e III-të S deri në çlirimin e atdheut nga pushtuesit nazifashistë.

Në këtë takim festiv, kryetarja e OBVLP, Znj. Parllaku - Çarkaxhiu falenderoi gjithashtu pasardhësit e denjë të kësaj organizate, veteranin 90 vjeçar Shuaip Methasani, sekretarin e përgjithshëm Halil Rama - Mjeshër i Madh, nënkryetarët e OBVLP: Muharrem Gjoka-Mjeshër i Madh; Zonjën fisnike e me inteligjencë të rrallë Mirjana Ohri e kolonel Trifon Llupo, shkrimtarin dhe publicistin e mirënjohur Sakip Cami, personalitetin e shquar të kulturës kombëtare Shaqir Rexhvelaj, shkrimtarin e shquar Vasil Premçi, mësuesin veteran shembullor Skënder Murrja, poetin Arben Alliu, Z. Hasan Shehu e Hasan Balla, kryetarin e degës së OBVLP Shkodër kolonel Ali Demushi, të Durrësit Shpendi Topollaj (ndër publicistët dhe shkrimtarët më të mirë në rang vendi), të Elbasanit Maksim Vinçani, Përmetit Muharem Kamani etj.

“Ne krenohemi me këta personalitete që aderojnë dhe i japin jetë organizatës tonë, duke punuar me përkushtim për të mbajtur gjallë kujtimin, veprën dhe idealet e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Ata dhe shumë pasardhës të tjerë të veteranëve, anëtarë të OBVLP, me shembullin e tyre, frymëzojnë brezat e rinj të rriten me dashurinë për vendin, për paqen dhe për njeriun”,-tha ndër të tjera Znj. Parllaku Çarkaxhiu. Ajo falenderoi pjesëmarrësit në këtë takim për kontributin, përkushtimin dhe ndihmën e çmuar në mbarëvajtjen e punëve të organizatës, në shërbim të veteranëve dhe pasardhësve të tyre — atyre që sakrifkuan gjithçka për lirinë dhe për ditët e lumtura që ne gëzojmë sot.



HISTORIA

Përballimi me sukses i Operacionit të egër Armik të Dimrit '1943-1944 ka qenë prova më e rëndë për UNÇL shqiptare dhe për popullin shqiptar

83 vjet më parë – Operacioni i madh armik i Dimrit 1943-1944

Ing. Myfit GUXHOLLI*

1. Faqe të lavdishme nga lufta heroike e Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Në fundin e vitit 1943, Ushtria Nacionalçlirimtare ishte rritur e forcuar dhe godiste pa pushim armikun. Në këtë kohë, e favorizuar dhe nga kushtet e jashtme si fitoret e Ushtrisë Sovjetike dhe të Aleatëve, Ushtria Nacionalçlirimtare kishte çliruar edhe mjaft qytete si Dibra, Peshkopia, Kruja, Berati, Gjirokastra dhe harta e territoreve të çliruara po shtrihej deri në Vlorë. Po rrezikoheshin rrugët e Lëvizjes së Ushtrisë Naziste. Kjo gjendje e shqetësonte shumë komandën gjermane. Në këto kushte, kryekomandanti i forcave naziste gjermane deklaronte: "Deri tani ne i kemi besuar mikpritjes dhe besës shqiptare, por nuk mundemi të durojmë më gjatë sulmet; duhet të marrim masa për sigurinë tonë". Në të njëjtën kohë, qeveria tradhtare e Tiranës, u vu drejtpërdrejt në shërbim të okupatorit dhe mobilizoi forcat e veta për të asgjësuar forcat partizane. Gjermanët iu vunë punës për përgatitjen e një operacioni ushtarak të përgjithshëm në Shqipëri. Qëllimi i këtij operacioni synonte asgjësimin e UNÇL dhe shkatërrimin e këshillave Nacionalçlirimtare, për të vendosur pushtetin e bashkëpunësorëve të tyre.

Forcat naziste gjermane që vepronin në Shqipëri u përforcuan me forca të tjera të ardhura nga Greqia e Jugosllavia dhe që hynin në përbërjen e katër divizioneve gjermane (297, 181, 21, 104.) Efektiviteti i këtyre forcave armike arrinte rreth 30.000 veta, përveç afro 12.000 forca të Ballit Kombëtar e Legalitetit. Komandanti i Përgjithshëm i Operacionit ishte gjenerali nazist Fehm. Ndërsa forcat e UNÇL arrinin rreth 20.000 luftëtarë; shumica e tyre të inkuadruar në batalione, grupe e brigade të rregullta (4 brigada, 9 grupe dhe 17 batalione). Armatimi i tyre ishte i thjeshtë: pushkë automatike, mitraloza të lehtë e të rëndë. Burimi kryesor i furnizimit të forcave partizane me veshmbathje, ushqim dhe municion ishte populli ndërkohë që llogaritej edhe furnizimi nga aleatët dhe kapja në luftë e depove dhe materialeve të ndryshme të armikut. Ajo kishte moral shumë të lartë dhe disiplinë të shëndoshë e të ndërgjegjshme sepse partizanët luftonin për një gjë të shenjtë, çlirimin e atdheut. Komanda gjermane, pasi kishte përpunuar planin e operacionit dhe kishte bërë përgatitjet e nevojshme filloi nga zbatimi i tij qysh në Nëntor 1943 duke sulmuar UNÇL në zonën e Pezës dhe pastaj me radhë në zonat e Dibrës, Mallakastrës, Çermenikës, Shëngjergj-Martanesht, Korçës, Beratit, Gjirokastrës dhe Kurvelesh-Salari-Mesaplikut. Pas disa goditjeve të vogla, komanda gjermane nazifashiste, kolaboracionistët e armatosur deri në dhembë goditjen kryesore e dhanë kundër forcave të Brigadës së 3-të dhe Grupit të Pezës. Forcat armike sulmuan nga drejtimet: Tirana, Ndroqi, Shijaku, Kavaja, Rrogozhina e Peqini me qëllim rrethimin dhe asgjësimin e forcave

• *Gjatë Operacionit Armik të Dimrit u çimentua dashuria dhe besimi i patundur i luftëtarëve të lirisë për detyrën e lartë të çlirimit të Atdheut..., u rrit ndërgjegjja dhe përkushtimi i partizanëve për një organizim të përsosur, manovër të shkëlqyer e disiplinë të lartë të UNÇL. U rrit në shkallën më të lartë besimi i popullit tek Ushtria Nacionalçlirimtare si e vetmja forcë që do ta çlironte vendin nga pushtuesit gjermanë*

partizane. Këto të fundit, megjithëse të armatosura me armë të lehta, pa ushqime dhe veshmbathje, në kondita dimri luftuan me trimëri të rrallë.

Shtabi i Përgjithshëm, duke vlerësuar rezistencën e armikut vendosi që Brigada e 3-të të kalonte në zonën e Çermenikës duke manovruar për të çarë rrethimin. Në të njëjtën kohë, Grupi i Pezës u urdhërua të luftonte me grupe të vogla kundër forcave armike të dislokuara në zonën e Pezës. Ushtria nazifashiste mundi të përshkonte zonën e Pezës gjatë operacionit. Këtu ajo dogji, vrau e shkatërroi, por partizanët e Pezës nuk mundi t'i asgjësonte.

2. PARTIZANËT I ZBATUAN ME PËRPIKËRI DETYRAT

Pas operacionit të Pezës, okupatorët nazistë kryen sulme kundër forcave partizane të Dibrës e Peshkopisë. Edhe këtu partizanët luftuan me trimëri, por në pamundësi manovrimi në ato zona, detashmentet partizane në kondita të disfavorshme karshi armikut marrin urdhër për tu tërhequr dhe të kalonin në drejtim të Shqipërisë së Mesme e të Jugut. Njëkohësisht edhe zona e Tropojës nuk shpëtoi nga operacioni duke u sulmuar nga forcat gjermane dhe ato të Xhaferr Devës, të cilat pasi e shkelën, e dogjën, plaçkitën popullin, arrestuan dhe rrahën në gjithë zonën e Malësisë. Operacioni në krahinën e Mallakastrës u krye me forca të mëdha. U pushtua Berati dhe u vazhdua për në drejtim të Mallakastrës ku ishte përqendruar një pjesë më e madhe luftarake e UNÇL për atë kohë, Brigada I Sulmuese. Forcat gjermane në bashkëpunim me ato kolaboracioniste sulmuan në drejtim të Fierit e Beratit. Në Gllavë sulmuan forcat kolaboracioniste së bashku me ato naziste gjermane. Pra, forcat partizane ishin të rrethuara nga të gjitha anët. Mjaftonte një gabim i vogël dhe forcat partizane të asgjësoheshin. Komanda e Brigadës I Sulmuese, nën drejtimin e shokut Mehmet Shehu e vlerësoi drejt situatën dhe mori vendimin për të dalë nga rrethimi që po i përgatiste armiku. Partizanët zbatuan me përpikëri detyrat dhe duke përdorur Lëndrën e Vogël të Memaliaj kaluan lumin Vjosë për në krahinën e Mesaplikut. Në operacionin e krahinës së Mesaplikut e të Kurveleshit të Poshtëm, forcat e Brigadës I Sulmuese dhe ato të Zonës I Operative Vlorë-Gjirokastrë zhvilluan luftime të përgjakshme, duke i shkaktuar humbje të mëdha armikut në Vajzë, Gjorm e Qafa e Shëngjergjit. Forcat partizane, duke mos dashur të angazhoheshin në luftime të gjata frontale përpara një armiku superior në forca e mjete, me një manovrim të shpejtë u tërhoqën nga pozicionet e para dhe zunë vijën Bolenë-Vranisht duke zh-



villuar luftime të rrepta. Njëkohësisht ato kaluan në zonën e Kurveleshit të Sipërm. Më vonë, forcat kryesore të Brigadës manovruan në zonën e Zagorisë e Lunxhërisë. Një pjesë e tyre u bashkuan me forcat partizane të Qarkut të Vlorës duke kaluar prapa krahëve të armikut për tu kthyer përsëri në Mesaplik e Kurvelesh duke pastruar këto zona nga kolaboracionistët dhe armiku nazist.

3. Çarja e rrethimit në malet e Martaneshit e Çermenikës

Në 15-ditshin e dytë të Dhjetorit 1943, forca të shumta naziste gjermane dhe kolaboracioniste filluan operacionin kundër forcave partizane që vepronin në zonën Çermenikë-Shëngjergj-Martanesht. Para se të fillonin operacionin bënë disa goditje kundër partizanëve dhe përforcuan pozitat e tyre gjatë rrugës automobilistike Qaf e Thanës-Elbasan-Tiranë. Qëllimi i armikut ishte që forcat partizane të Brigadës 2-të e 3-të, si dhe batalionet e Çermenikës e Martaneshit të mbeteshin të izoluar dhe të asgjësoheshin. Me

këto forca partizane ndodhej edhe Shtabi i Përgjithshëm. Ishte rasti që Shtabi i Përgjithshëm të tregonte më së miri organizimin e këtyre luftimeve kundër forcave të shumta armike të armatosura më së miri. Ai duhej të grumbullonte forcat e dy brigadave, asaj të 2-të e të 3-të si dhe të batalioneve të Martaneshit e Çermenikës në një komandë të vetme dhe të luftonin duke sulmuar e mbrojtur që të mund të çanin rrethimin. Por Shtabi i Përgjithshëm, sidomos Enver Hoxha vetë i katërt vendosi të largohesh në Jug të vendit, në zonën e Polisit. Ndërsa forcat partizane u lanë në dorë të shtabeve të tyre duke rrezikuar edhe shpërbërjen. Këto forca partizane luftuan me trimëri dhe vetëmohim për të çarë rrethimin dhe me manovër të shpejtë arritën të shkëputeshin nga forcat gjermane dhe ato kolaboracioniste. Humbjet e këtyre forcave, sidomos të Brigadës së 2-të ishin shumë të mëdha. Forcat e Brigadës së 3-të kaluan në zonën e Matit e Lurës dhe më vonë në atë të Pezës

Vijon në faqen 5

82 VJETORI

Periudha e pasluftës u shndërrua në një kapitull të rëndë për shqiptarët e Kosovës

Nga Bujani te veriu i Kosovës: një histori e mohuar dhe e përsëritur

Nga Bashkim Hisari

Historia e Kosovës në shekullin XX dhe në fillimin e shekullit XXI është historia e një vullneti politik të mohuar, por kurrë të shuar. Është histori sakrifice, përjashtimi, rezistence dhe, më në fund, lirie të fituar me çmim të lartë. Por është edhe historia e një fqinji që, pavarësisht kohës dhe rrethanave, refuzon të përballet me të kaluarën e vet. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, rreth 53 mijë luftëtarë nga Kosova iu bashkuan Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Mbi 6 mijë prej tyre ranë dëshmorë. Ky kontribut masiv e radhiste popullin shqiptar të Kosovës natyrshëm përkrah kombeve fituese të luftës dhe i jepte legjitimitet të plotë politik për të ardhmen. Megjithatë, në Jajce, në nëntor të vitit 1943, AVNOJ-i ndërtoi Jugosllavinë e re federative pa shqiptarët si subjekt politik. Ata u reduktuan në "kombësi", një kategori që nënkuptonte përjashtim nga sovraniteti dhe mohimin e të drejtës për vetëvendosje.

Rezoluta e Bujanit ishte përgjigjja e qartë ndaj kësaj padrejtësie. Ajo nuk ishte akt rebelimi, por kërkesë për zbatim të parimeve antifashiste dhe demokratike mbi të cilat pretendohet se po ndërtohej Jugosllavia e re. Por Beogradi zgjodhi rrugën e imponimit. Vendimi i 18 shkurtit 1945 për aneksimin e Kosovës nga Serbia dhe "Kuvendi i Prizrenit" – një farsë e zhvilluar nën trysni ushtarake – vulosën fillimin e një kapitulli të errët represioni.

Periudha e pasluftës u shndërrua në një kapitull të rëndë për shqiptarët e Kosovës. Administrata ushtarake, represioni sistematik i KOS-it dhe UDB-së

- *Gjatë Luftës së Dytë Botërore, rreth 53 mijë luftëtarë nga Kosova iu bashkuan Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar. Mbi 6 mijë prej tyre ranë dëshmorë. Ky kontribut masiv e radhiste popullin shqiptar të Kosovës natyrshëm përkrah kombeve fituese të luftës dhe i jepte legjitimitet të plotë politik për të ardhmen....*


nën drejtimin e Aleksandar Rankoviçit, arrestimet, torturat dhe shpërnguljet drejt Turqisë, si dhe goditjet ndaj veteranëve të LANÇ-it dhe elitës intelektuale, e kthyen Kosovën në zonë të kontrollit të posaçëm politik dhe etnik. Diskriminimi institucional dhe dhuna shtetërore lanë pasoja të thella shoqërore, ekonomike dhe demografike. Veteranët e LANÇ-it dhe intelektualët shqiptarë, për shkak të kundërshtimit të tyre ndaj politikave shtypëse të regjimit, u përballën me forma të ndryshme represioni politik dhe shoqëror. Edhe kur demonstratat e vitit 1968 dhe Kushtetuta e vitit 1974 sollën një autonomi të zgjeruar, ajo mbeti e përkohshme. Demonstratat e vitit 1981 dëshmuar se problemi i Kosovës nuk ishte zgjidhur, por vetëm shtyrë. Represioni u rikthye, kësaj here më brutal. U bë e qartë se problemi nuk ishte zgjidhur, por vetëm ishte shtyrë në kohë. Vitet '90 e nxorën lakuriq fytyrën e vërtetë të nacionalizmit serb. Në këtë kontekst, LDK-ja, nën udhëheqjen e dr. Ibrahim Rugovës, veprroi si një lëvizje paqësore dhe intelektuale, duke promovuar rezistencën paqësore, negociatat politike dhe mbrojtjen e të drejtave kombëtare shqiptare.

Pas shfaqjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në vitet 1998–1999, dhu-

na dhe krimet sistematike serbe arritën kulmin dhe u shndërruan në një tragjedi me përmasa të mëdha njerëzore. Mbi 13 mijë të vrarë, mijëra të zhdukur, dhjetëra mijëra gra të dhunuara dhe rreth një milion shqiptarë të dëbuar çuan në ndërhyrjen e NATO-s për të ndaluar spastrimin etnik dhe për të mbrojtur popullsinë civile.

Sot, Serbia vazhdon të jetojë nën hijen e së njëjtës ideologji. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq, produkt politik i Partisë Radikale Serbe dhe ish-ministër i propagandës i regjimit të Millosheviçit, ka ndër-tuar një regjim të centralizuar, autoritar dhe thellësisht nationalist. Nën kontrollin e tij ndodhet i gjithë aparati represiv shtetëror, ndërsa grupe paramilitare të lidhura me pushtetin, të përbëra nga hulumtarë dhe elementë kriminalë, veprojnë pa ndëshkim.

Albanofobia ndaj shqiptarëve është bërë pjesë e zakonshme e diskursit publik në Serbi. Ajo shfaqet përmes stereotipeve denigruese dhe një gjuhe që kriminalizon një popull të tërë, duke e paraqitur atë si kërcënim kolektiv. Shqiptarët etiketohen si terroristë, banditë, kriminelë, kontrabandistë droge, uzurpatorë dhe dhunues. Këto emërtime nuk janë thjesht fjalë, por mjete stigmatizimi që nxisin frikë dhe urrejtje. Ky diskurs përfaqëson një formë ra-



cizmi të kamufluar dhe një neofashizëm të heshtur, të ushqyer nga propaganda dhe heshtja institucionale. Në këtë realitet, Serbia sot gjendet rrezikshëm pranë totalitarizmit të hapur, despotizmit dhe vendosjes së tiranisë. Kosova mbetet mjeti kryesor për mobilizim të brendshëm politik dhe ideologjik. Kjo vazhdimësi ideologjike u pa qartë edhe kohë më parë, më 7 janar 2026. Krishtlindja, festa e paqes, në televizionin Informer u shndërrua në një manifestim të hapur urrejtjeje. Në prani të krerëve më të lartë shtetërorë – kryetares së Kuvendit të Serbisë, zëvendëskryeministrit, ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Drejtësisë, ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të lartë – përkrah kriminelit Vojislav Sheshel, i akuzuar për krime lufte në Tribunalin e Hagës, u kënduan këngë çetnike profashiste, mes euforie dhe duartrokitjesh. Ishte një skenë simbolike: shteti serb, edhe një herë, i rreshtuar me të shkuarën e vet më të errët. Shqiptarët, që kanë kaluar traumat e luftës së viteve '90, përballën ende me tensione të shkaktuara nga struktura serbe të lidhura me krime të rënda gjatë luftës në Kosovë. Këta aktorë, që kryesisht veprojnë në veri të Kosovës, krijojnë tensione përmes organizimit të demonstratave të dhunshme, veprimeve diversive, sulmeve frontale ndaj pjesëtarëve të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës, si dhe përmes akteve terroriste kundër rendit, sigurisë dhe sovranitetit të Kosovës. Këto veprime dëshmojnë se Serbia vazhdon të instrumentalizojë dhunën dhe ekstremizmin për të destabilizuar rajonin, pa u përballur me pasoja reale nga bashkësia ndërkombëtare.

Kosova përkundër kërcënimeve, ka zgjedhur rrugën e paqes, demokracisë dhe integriteteve euroatlantike. Dallimet politike të brendshme nuk duhet të pengojnë unitetin rreth çështjeve kombëtare dhe mbrojtjen e shtetit. Kosova, nga Bujani deri sot, mbetet histori e një vullneti të mohuar, por kurrë të shuar.

83 vjet më parë – Operacioni i madh armik i Dimrit 1943-1944

ndërsa forcat e Brigadës së 2-të kaluan në zonën e Tiranës e Krujës. Veprimet luftarake të forcave partizane në operacionin e Shëngjergj-Martanesh-Çermenikës, si rrjedhojë i një vlerësimi jo të drejtë të situatës nga Shtabi i Përgjithshëm me Enver Hoxhën në krye u shoqëruan nga një humbje e madhe e forcave partizane dhe nga një imazh i keq. Pas këtyre goditjeve të vogla në të gjitha qarqet e vendit, më 7 janar 1944 filloi Operacioni Armik i Dimrit, njëherësh në zonën e Korçës, Elbasanit e Beratit. Armiku synonte ti shtynte forcat partizane sa më në Jug, t'i rrethonte dhe ti asgjësonte ato. Brigada e 4-të luftoi me trimëri e heroizëm në vijën e frontit....- Voskopojë-Gjergjeviç dhe nuk i lejoi forcat gjermane të përparonin. Ndërsa në zonën e Beratit, në drejtim të Tomoricës dhe nga Elbasani armiku mundi të përparojë dhe arriti në Mazrekë të Oparit. Kjo dalje vuri në rrezik forcat e Brigadës së 4-të e cila me një manovër të shpejtë çau rrethimin duke kaluar në Qafën e Beçit (Mali Ostrovicë) dhe kaloi në Potom (Skrapar). Gjermanët pushtuan Tomoricën, Sulovën, Nahijën e Beratit, Gorën dhe Oparin duke kryer një terror të paparë nëpër fshatra me synimin për të

shkëputur nga lufta masat e popullit. Tentativa e armikut ishte që të dilte nga Çorovoda në Tendën e Qypit për në Përmet. Forcat partizane të Qarkut të Beratit dhe sidomos forcat e Brigadës së I-rë luftuan heroikisht në Tendën e Qypit duke arritur që ti ndalojnë dhe ti detyrojnë të tërhiqen gjermanët. Një ndihmë të madhe dhanë dhe forcat partizane të Brigadës së 6-të që sapo ishte formuar në Përmet.

Gjermanët kudo që shkuan dogjën, vranë dhe plaçkitën por nuk ia arritën qëllimit për të shpartalluar Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Armiku po të njëjtin operacion bëri edhe në Qarkun e Vlorës kundër Brigadës së 5-të e cila u rrezikua seriozisht, por manovrimi i saj dhe ndihma e popullsisë bëri që ajo, jo vetëm të çante rrethimin, por ta godiste armikun në befasi.

4. Mësymja e përgjithshme e UNÇL

Kur nazistët gjermanë dhe kolaboracionistët po i jepnin fund operacionit në pamundësi të asgjësimit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, forcat e UNÇL u hodhën në mësymje: Brigada e 5-të në Qarkun e Vlorës, Brigada e 4-të në Qarkun e Korçës, Brigada I Sulmuese në Qa-

rkun e Beratit, Brigada e 6-të në zonën e Lunxhërisë e Zagorisë. Kështu ata i dhanë goditje të fortë armikut dhe filluan të çlirojnë të gjitha zonat që kishte pushtuar ai gjatë operacionit.

Përballimi me sukses i Operacionit të egër Armik të Dimrit '1943-1944 ka qenë prova më e rëndë për UNÇL shqiptare dhe për popullin shqiptar. Në luftime të ashpra në kushte të pabarabarta, në një dimër jashtëzakonisht të vështirë humbjet e partizanëve ishin mbi 1000 veta por radhët e UNÇL shqiptare u shtuan dhe u forcuan, ndërkohë u rrit besimi i popullit në fitoren mbi pushtuesin. Gjatë Operacionit Armik të Dimrit u çimentua dashuria dhe besimi i patundur i luftëtarëve të lirisë për detyrën e lartë të çlirimit të Atdheut..., u rrit ndërgjegjja dhe përkushtimi i partizanëve për një organizim të përsosur, manovër të shkëlqyer e disiplinë të lartë të UNÇL. U rrit në shkallën më të lartë besimi i popullit tek Ushtria Nacionalçlirimtare si e vetmja forcë që do ta çlirointe vendin nga pushtuesit gjermanë.

**Ish-partizan i Brig.IV S- Ish nunkreyar dhe kryetar i OBVL P- nga arkiva e gazetës "Veterani"*

FJALA

PREJ 35 VITESH SI SHKOLLË 9-VJEÇARE VAZHDON TRADITA E PASUR E ARSIMIMIT DHE EDUKIMIT TË BREZIT TË RI

Tradita e arsimimit në shkollën 100-vjeçare “Ahmet Cami” të Gjoricës

Tefta CAMI*

• **Para çlirimit dhe gjatë LANÇ në shkollën fillore kanë punuar mësuesit: dëshmorit i Atdheut e “Mësuesi i Merituar” Fasli Fet Cami, që i vetmi që nuk pranoi të ishte anëtarë i partisë fashiste, por jepte mësim, duke mbatur pushkën të varur tek dera e klasës. Ka punuar edhe Haxhi Ademi si mësues e kryemësues**

Tradita ka të bëjë me vazhdimin e identitetit kombëtar arsimor e kulturor të këtij institucioni kryesorë e të rëndësishëm në dy fshatrat e Gjoricës dhe në krahinën e Grykës së Vogël.

Mora pjesë si e ftuar në festimin e 100 vjetorit të çeljes së Shkollës së Parë në Gjoricë, në të cilën janë arsimuar dhe edukuar mijra djem e vajza, që janë arsimuar më tej dhe kanë shërbyer me devocion e përkushtim për zhvillimin e përparimin e mëmëdheut ndër vite!

Në festë foli drejtoresha e Shkollës, znj. Eliona Alimani për historikun e krijimit të shkollës fillore me 2 shtator të vitit 1925-së si rezultat i përpjekjeve të mëdha të patriotëve të fshatit Gjoricë e të krahinës së Grykës së Vogël e të qytetit të Dibrës së Madhe.

Drejtoresha foli edhe për vazhdimësinë e kësaj shkolle, për përvojën e pasur të krijuar nga mësuesit e drejtuesit e saj për arsimimin e edukimin e shumë brezave të rinj ndër vite dhe si misionarë të dijes e kanë shdërruar këtë institucion arsimor në një vatër dije e kulture, që rrezaton këtu në fshat e në gjithë krahinën e Grykës së Vogël dije e kulturë të gjithanëshme.

Përhëndeti kryetarja e Bashkisë të rrethit të Bulqizës, znj. Festime Mjeshtril!

Përhëndeti drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar në Durrës, z. Hazbi Lika.

Përhëndeti Drejtori i Zyrës Arsimore të rrethit të Bulqizës, z.Fatos Muha.

Përhëndeta dhe fola edhe unë për këto:

Përhëndes gjithë pjesëmarrësit!

Përhëndes kryetaren e Bashkisë, znj. Festimeime Mjeshtri, që tregon kujdes për fshatin e Shkollën e Gjoricës!

Përhëndes drejtoreshën e Shkollës, znj. Eliona Alimani, që përshkroi shumë bukur historinë e pengesat dhe vështirësitë, që kanë kapërcyer patriotët dibranë për hapjen e Shkollës që në vitin 1925-së, si dhe vlerësoi kontribuesit e shkollës ndër vite!

Para çlirimit dhe gjatë LANÇ në shkollën fillore kanë punuar mësuesit: dëshmorit i Atdheut e “Mësuesi i Merituar” Fasli Fet Cami, që i vetmi që nuk pranoi të ishte anëtarë i partisë fashiste, por jepte mësim, duke mbatur



pushkën të varur tek dera e klasës. Ka punuar edhe Haxhi Ademi si mësues e kryemësues.

Shkolla 7-vjeçare pas Çlirimit të vendit ka filluar me 5 tetor të vitit 1945-së, kur ka filluar gjithë Sistemi Arsimorë në të gjithë Shqipërinë, sipas Programit për Sistemin Arsimorë të firmosur nga kryeministri i atyre viteve, Enver Hoxha.

Në Shkollën 7-vjeçare të Gjoricës ka qenë mësues Hamit Manjani, që kishte mbaruar Normalen e Elbasanit dhe kishte marrë pjesë në LANÇ në Çetën e Malit të Gollobordës me komandant Ahmet Camin të krijuar që në janar të vitit 1940. Ai u ka dhënë mësim nxënësve të gjitha lëndët dhe në të gjitha klasët.

Vajzat e para që vinin nga Golovishti për ditë për të vazhduar Shkollën 7-vjeçare në Shkollën e Gjoricës në vitin 1948-të kanë qenë dy motrat e mija, Drita e Femija dhe vajza e mixhës tim, Meribani, që thyen mentalitetet e prapambetura ndaj grave e vajzave. Pas tyre vazhduan edhe vajza të tjera nga Gjorica e Çereneci.

Femije Cami pas mbarimit të kësaj Shkolle, dha mësim në Kursin Kundër Analfabetizmit me gratë e fshatit Viçisht dhe pastaj punoi si mësuese në Shkollën Fillore të Viçishtit, në Peshkopi, në Burrel e në Tiranë. Ajo është e njihet si mësuesja e parë femër në këtë krahinë.

Vizitën e parë si ministre të Arsimit dhe Kulturës me vëllain tim Moisin, që ishte drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar: bujqësore, ekonomike, pedagogjike, mjekësore për të gjithë zonat Veri-Lindore, e kam bërë këtu në Shkollën 7-vjeçare të Gjoricës, se paraardhësit e mij kanë jetuar në Gjoricë dhe e quaj veten, se jam nga Gjorica.

(Fshati Gjoricë, sipas hartave të vjetra, z. Besnik Kebej, e ka nxjerë, se ka qenë kryeqytet i Shtetit të Parë të Arbërit dhe quhej Albanopolis. Fsha-

ti Gjoricë si pozicion gjeografik, është qendra e gjithë trevave Shqiptare. Edhe në një varg të këngës kundër Hajredin pashës, shënohet:

“Oj Gjoricë, gjysëm kasaba!”

–Moisi i pyteti nxënësit: A i dini, se cilët fshatra janë përtej Drinit?

–Nxënësit iu përgjigjën njëzëri: Jugosllavia.

–Jo, u tha Moisi. Atje janë fshatra të Shqipërisë përtej kufirit dhe ua tregoi një për një emërtimet e fshatrave si, Bomova, Spasi, Sollokiçi, Reshani nga është edhe presidenti i Shqipërisë dhe atje lartë është qyteti shqiptar i Dibrës së Madhe, që banojnë shqiptarë. Fuqitë e Mëdha europiane ua dhanë padrejtësisht 60-70-të përqind të trevave shqiptare mbretërive të Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë.

Moisi m'u kthye mua: E shikon që në gjithë Sistemin Arsimorë në Shqipëri nuk jepen njohuri në lëndët e gjeografisë dhe të historisë për Shqipërinë përtej kufirit.

Atëhere në Ministri të Arsimit dhe Kulturës ngritëm një grup pune dhe bëmë një studim, për dhënien e njohurive në lëndët e gjeografisë e të historisë në të gjitha ciklet e shkollës, ku jepeshin këto lëndë. Ministria e Jashtme e Shqipërisë ishte kundër dhe na u përgjigjën: “Është ndërhyrje në punët e brendëshme të Shteteve, ku janë trevat shqiptare!”

Studimin ia paraqitëm Byros Politike të KQ të PPSH-ës për miratim. Materiali i studimit ndodhet në AQSH në Fondin e KQ të PPSH-ës dhe në Fondin e Ministrisë të Arsimit dhe Kulturës. Meqë isha e bindur, se do ta miratonin, i futa në planet e programet dhe hartuam tekstet e leksionet dhe filluan të marrin njohuri nxënësit e studentët për Shqipërinë përtej kufirit.

Në vitin 1978 me rastin e Kremtimit të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare

të Prizrenit që në Konferencën Shkencore që zhvilloi punimet në Tiranë dhe në rrethe nga Akademia e SHkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, si dhe institucionet e Larta të Shqipërisë e Kosovës si, Universiteti e Institutet e Larta në Tiranë e rrethe dhe Universiteti i Prishtinës e Institutet e tjera të Larta në Kosovë, si dhe me pjesëmarrjen e studiusve të tjerë edhe nga Shqipëria përtej kufirit, arbëreshë të Italisë e të Kroacisë, si dhe studiusë të huaj nga Europa e Azia. Në atë Konferencë Shkencore për herë të parë në referate e kumtesa u fol hapur për Programin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të mbajtur me 10 qershor të vitit 1878, që Ministria e Arsimit dhe Kulturës i pasqyro i në tekstet shkollore.

Nga viti 1968 deri sa shpërthyen demonstratat të studentëve të Universitetit të Prishtinës e të nxënësve të shkollave të mesme e

8-vjeçare dhe popullsisë shqiptare në Kosovë në mars-prill 1981 me parrullat: “Kosova Republikë”, “Republikë-Kushtetutë-Ja me hatër ja me luftë!”, gjithë Sistemi Arsimorë në Kosovë mësonin me tekstet e shkollave të Shqipërisë që, pasi u hiqnin politizimet, i ribotonin dhe i përdornin në të gjithë Sistemin Arsimorë në Shqipërinë përtej kufirit. 80 përqind të programit në Universitetin e Prishtinës dhe të Instituteve të Larta në Kosovë i zhvillonin pedagogët e Shqipërisë.

Në ato vite arsimit e kultura shqiptare kishin karakter kombëtarë.

Ndihem mirë, se kur isha ministre e Arsimit e Kulturës dhe Sporteve i bashkova Arsimin, Kulturën, Sportet e Shkencat Albanologjike me Institucionet e Shqipërisë përtej kufirit.

Përhëndes dhe ju uroj suksese

Vijon në faqen 7

PROFILI

Vlerësimi më i madh për mësuesin veteran është respekti i mijëra nxënësve e i qindra kolegëve të tij

Nga Xhemal Meçi
Mjeshtër i Madh


- Mësues Metodist për shumë shkolla të Pukës.
- Mësues e drejtor shkollash, Shtatëvjeçare e të Mesme.
- Hulumtues e mbledhës i Traditave Historike të Rrethit Pukë si edhe i “Fjalës së Rrallë”, (si akcion kombëtar).
- Referues në sesione Shkencore në Shkallë Rrethi për Traditat Historike e Arsimore.
- Një prej pjesëmarrësve aktiv të Rrethit të “Shoqatës së Mësuesve të Historisë” Pukë.
- “Qytetar Nderi” i dy Bashkive Fushë-Arëz e Pukë.

Vitet sikur i kanë kaluar shpejt, por pesha e tyre i ka lënë gjurmë të pashlyeshme mësuesit veteran Beslim Hoxha.

Është lindur më 20 prill të vitit 1935 në qytetin e Pukës, në një familje intelektuale e me tradita patriotike e lirdashëse. Që në moshë të vogël ëndërronte të bëhej i ditur e këtë dëshirë e realizon me vullnetin për të mësuar sa më shumë në shkollën e vendlindjes, në shkollën e mesme pedagogjike e më pas në Institutin e Lartë Pedagogjik, në degën Gjuhë- Letërsi-Histori, në Tiranë.

Viti 1954 shënon fillimin e punës në arsim si drejtor shkollë në lballë, detyrë të cilën e kryen deri më 1958. Larg vendbanimit, por mësuesi i ri përballon vështirësitë e të jetuarit e të ushtrimit të profesionit si mësues dhe shënon rezultate të mira në arsimimin e fëmijëve të kësaj shkollë. Në lballë kujton kolegët e tij, Ndue Pjetrin (“Mësuesi i Popullit”), Hamit Hebovia i ardhur nga Shkodra e Prendush Gjergjin nga Qelëza.

Në dosjen e Beslimit radhiten 36 vite punë në arsim. Nga lballa transferohet në Pukë me detyrën e N/drejtorit të shkollës “Jordan Misja”. Me 1962 e gjejmë drejtor shkollë në Flet. Me 1963-1965 drejtor shkollë në Kabash e Kryezi. Në vitet 1967-1969 është n/drejtor i



shkollës së mesme dhe drejtor i konviktit në qytetin e Pukës, më 1970-1975 drejtor i shkollës së mesme Fushë-Arëz. Më pas deri me 1990 mëson dhe edukon nxënësit e shkollave Qafë-Mali, Kryezi dhe Breg.

Një periudhë e gjatë kohe si mësues e drejtues institucioni hedh dritë mbi biografinë e punës së Beslim Hoxhës, si një ndër pionierët e parë të arsimit në vitet e pas çlirimit të vendit. Vlerësimi që i është bërë në të gjitha shkollat tregon për një mësues me shkallë të lartë kualifikimi e të vullnetshëm për punë. Firma e tij gjendet në veprimtaritë metodike-shkencore, si përgjegjës i kësaj fushe në zonën e lballës, në Fushë-Arëz, Kryezi, Qafë-Mali e në shkolla të tjera. Ai

BESLIM ELEZ HOXHA, personalitet i shquar i arsimit shqiptar



Beslimi me mbesën Flutura dhe vëllain Bilal.



Beslimi mes kolegësh.

është referues i disa temave me karakter shkencor e pedagogjik. Të tilla mund të cilësojmë temat: “Probleme të masivizimit të arsimit 8-vjeçar dhe detyrat që i dalin shkollës së reformuar”. “Drejtskrimi dhe të shprehurit dialektik”, “Te puna e mësuesi varet niveli cilësor i të mësuarit nga nxënësit” e punime të tjera që mësuesi i ruan në arkivin e tij.

Janë të shumta kujtimet dhe mbresat që ruan mësuesi gjatë 36 viteve të punës në sektorin e arsimit. Të tërheq vëmendjen një rrëfënjë e viteve rinore kur sapo ishte emruar mësues. “Po udhëtoja më këmbë, më thotë, - nga lballa për në Fushë-Arëz. Mbrëmja më zuri në Sapaç. Ndërsa kaloje rrugës, një fshatar, Qun Jaku e quanin, më ndaloi dhe pas

përshëndetjes më tha: - “Është vonë, hajde në shtëpi”. U binda. Më tërhoqi vëmendjen shtëpia e rregulluar mirë dhe mikpritja bujare e tij. Më përcollime dashmirësi por më tha: “Kujdes, mos i thuaj ndokujt ku ishe se të bëjnë fjalë”. Duket dikush më shikoi kur dola nga shtëpia dhe më raportoi se mësuesi ka zbutë luftën e klasave, ka shkuar te shtëpia e kulakut. Më thirrën dhe u tregova i sinqertë, më falën. Kështu më ka ndodhur edhe në fshatin Lëvoshë, ku shkolla e parë u hap në shtëpinë e Vat Jakut e dikush nga fshati, donte ta hiqte andej, mbasi Vata ishte me probleme biografie.

“Më ka bërë të mendohem, - më thotë, - se ndonëse vlerësohesha si mësues i mirë, më transferonin shpesh dhe gjithnjë larg mjedisit familjar zakonisht në zona të thella, Kur më emronin më thotën: “ke punuar mire ndaj do të shkosh në këtë apo atë shkollë për përforsim. “Bindesha” se vetë nga natyra ime nuk e kam në karakter “qarjen” për hallet e mia.. Dhe emrohej mësuesi në shkollat me prapambetje, por kur dorëzonte çelësat gjithnjë me vete merrte edhe fletën e lavdritimit e stimuj të tjerë.

Ndonëse nuk ka ndonjë dekoratë të lartë, për të pasqyruar vlerat e këtij mësuesi, ai ndjen kënaqësi kur shikon tre distinktiva “Mësuesi i dalluar” dhënë nga Ministria e Arsimit e Kulturës në vite të ndryshme.

Vlerësimi më i madh për mësuesin veteran është respekti i mijëra nxënësve e i qindra kolegëve të tij. Për të flasin me mirënjohje ish-nxënësit Kolec Daja (mjek), Inxhinierët Ndue Kola, Nikollë Pali e shumë të tjerë.

I pyetur për arsimimin e rrethit të afërm familjar Beslimi, na thotë se, falë përkujdesjes së babait tim Elez Hoxha (Kryetari i Parë i Komitetit Ekzekutiv të Pukës) dhe vullnetit tonë, ne sot kemi me arsim të lartë shumë prej pjestarëve të familjes sonë. Ato punojnë në shëndetësi, arsim. në drejtësi e sektorë të tjerë. Vetëm mjek janë ghashtë prej tyre. Cileson djalin e xhaxhait kardiologun Ali Hoxha, dy fëmijët e tij, mjek, Bilbilin (Kirurk i dalluar në shkallë Kombëtare) dhe Dardaneshën, vëllain e tij mësues të talentuar Musa Hoxhën, djalin Ylberin. Ato janë mbi 20 të tillë dhe japin kontributin e tyre në sektorë të ndryshëm ekonomiko-shoqëror.

Beslimi jeton prej disa vitesh në Tiranë, por vështrimin e hedh të 36 vitet e punës në arsim, te vendlindja e tij e dashur, te ish-nxënësit e kolegët. Ai skedon nga ditarët që ka mbajtur në vite dhe synon të botojë copëza jete me temë: -”Mbresa dhe kujtime në 36 vitet si mësues dhe edukator”

Por i shtyrë nga modestia për ta botuar sa më të përsosur. Besoj ia botojnë të bijtë e të bijat. Vdekja e tij është një humbje për traditat arsimore, shoqërore e familjare. Por jo më kot prof. Dr. Sulejman Sula në shkrimet e tij e quan: Beslim Hoxha, figurë e shquar e Arsimit Shqiptar.

Tradita e arsimimit në shkollën 100-vjeçare “Ahmet Cami” të Gjoricës

Vijon nga faqja 6

gjithë mësuesve e drejtuesve, që punojnë në këtë Shkollë apo kanë punuar me dashuri e pasion dhe kanë krijuar një traditë të pasur 100 vjeçare për edukimin e arsimimin e brezit të ri!

Sami Frashëri, një nga Rilindësit tanë të mëdhenj dhe një nga 10-të filozofët e shquar shqiptarë ka thënë: “Në do pasuri, mbill misër e grurë, në do harmoni, mbill pemë e lule, në do të ardhmen e kombit mbill Dituri. Dituria e bën njeriun të lirë dhe të pavarur. Arsimi nëpërmjet dijeve që jep e bashkon kombin shqiptarë.”

Prandaj mësuesit kanë patur e vazhdojnë të kenë një mision të madh që diturit t’i shërbejnë bashkimit kombëtarë.

Në shtesë të kësaj përshëndetje,

dua të sqaroj për hapjen e shkollave shqipe.

Në radhë të parë, mësimin e gjuhës shqipe fëmijëve për ta folur ua mësonin nënat e baballarët e pjestarët e tjerë të familjes, sepse nga pushtuesit e huaj serbë e bullgarë dhe osmanllijtë ishte e ndaluar hapja e shkollave dhe për të folurit shqip në zyra e në publik. Pushtuesit kishin hapur shkollat e tyre, që i mësonin fëmijët shqiptarë në gjuhën e tyre. Patriarkana greke e kishte mallkuar gjuhën shqipe.

Kryeveziri i Sulltanatit të Stambollit i thotë Sulltanit: “Shqiptarët janë shumë të rrezikshëm. Prandaj ky popull duhet mbajtur në errësirë! Po u zgjuan shqiptarët, nuk do të ketë as Turqi dhe as Europë”. Prandaj Sulltani nuk lejonte hapjen e shkollave në gjuhën shqipe në trevat shqiptare

të perandorisë osmanllie. Por fëmijët shqiptarë mësonin fshehurazi në Monumentet e Kultit si kisha e xhamija dhe nëpër familje ku mësonin shkrim e këndim dhe merrnin njohuri për historinë dhe shkencat.

Hapja e Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë në vitin 1887 quhet e tillë, se u bë me iradenë e Sulltanit, që arritën t’ia marrin vëllezërit: Naim e Sami Frashëri. Ata kanë hartuar tekste të Abetares, si dhe disa autorë të tjerë, siç i përmendi drejtoresha e shkollës.

Mësonjëtorja e Parë Shqipe unifikoi planet e programet me shkollat Europiane. Këtë sqarim e kam bërë edhe pas vitit 2000, kur kam vizituar Muzeun e Arsimit në Korçë.

***Ish Ministre e Arsimit dhe Kulturës**

IN MEMORIAM

Në përkujtim të luftës, jetës dhe veprës të antifashistes Anastasia (Cia) Jani Mandro (12.9.1923 - 25.4.2020) dhe vëllait të saj Dhimitër Mandro (1921-1985)



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

VLORA E FLAMURIT ME SHKËLQIMIN VEZULLUES TË VAJZAVE PARTIZANE

Nëse kërkojmë në kujtesën historike të mbi tetë dekadave më parë e deri më sot për vajzat e gratë vlonjate është një emër i shquar Anastasia (Cia) Mandro. Ajo bënte pjesë në armatën e antiashistëve që përbushën detyrën ndaj Atdheut dhe kombit në kohët më të rrezikuara të pushtimit. Emri i saj ndrin në emrat e luftëtarëve që shkruan epope lirie e çlirimi në librat e Luftës Nacionalçlirimtare. Është fakt se vajzat dhe gratë shqiptare gjatë luftës antifashiste u bënë aktor dhe faktor në historinë tonë kombëtare. Gratë shqiptare përgjatë shekujve të mbijetesës nga pushtuesit kanë luftuar krah për krah vëllezërve, luftëtarëve të lirisë dhe kanë qenë burim frymëzimi nëpër breza. Në djepet vlonjate, të Labërisë dhe mbarë Shqipërisë janë përkundur trimëresha, heroina, janë përkundur ëndërrat e lirisë së truallit arbëror. Gratë shqiptare që shkruan lavdi me gjakun e tyre janë të shumta në të gjitha betejat, por veçanërisht përgjatë LANÇ-it në rreshtat partizane u rreshtuan qindra gra e vajza në formacionet luftarake, pa llogaritur qindra mijëra të tjera që mbështetën luftën në të gjitha frontet luftarake. Mbi 6000 gra dhe vajza shqiptare shkruan denjësisht me shkronja të arta në panteonin e kombit heroizëm, guxim, trimëri, mençuri dhe përgjakje me bishën nazifashiste. Në luftën partizane në përballje me ushtrinë naziste, u plagos dy herë gjatë LANÇ-it dhe vajza vlonjate Anastasia (Cia) Mandro, e bija e Janit dhe Aspasisë. U derdh shumë gjak për të bindur lirinë dhe çlirimin e Atdheut nga robëria nazifashiste. Disa prej tyre që i "kurseu" plumbi i armikut, lufta i rriti si luftëtarë dhe drejtues të formacioneve partizane. Qëndresa e vajzave vlonjate dhe të gjithë Shqipërisë çuditi edhe vet hitlerianët, kur iu desh të përballlej me qëndrimin e tyre edhe përpara litarit apo skuadrave të pushtkatimit. Qëndrimet e Bule Naipit, Persefoni Kokëdhimës, Fato Berberit përpara litarit i dhanë vlera e shkëlqim heroizmit të vajzave dhe grave shqiptare në atë luftë. Lufta çlirimtare pati shumë gjak të derdhur, por dhe shumë të plagosur, që u bënë kurora e lavdisë partizane. Vajza vlonjate Cia Mandro doli partizane bashkë me të vëllain Dhimitrin e vendosur dhe krenare për ndërmarrjen më të vështirë të jetës, mori dy plagë lufte por që u mundësua që të shpëtonte nga kthetrat e vdekjes, edhe me mbështetjen e Shtabit Aleat të Mesdheut në Itali. Gjatë transportimit kishte humbur shumë gjak deri përtej Adriatikut në Bari, përmes një shtegu të vështirë dhe jashtëzakonisht kompleks, në kushtet kur bregdeti dhe portet ishin të zaptuara nga pushtuesit gjer-

manë. Transportimi është bërë nga shpella e famshme e Karaburunit, që ishte në zotërim të forcave aleate si një pikë strategjike e linjës së komunikimit me Shtabin e Mesdheut, ku në fakt janë mjekuar dhjetra partizanë të plagosur rëndë dhe shpëtuan për ta parë Shqipërinë të lirë.

TË LINDUR NË VLORËN E FLAMURIT, TË PAVARËSISË, TË VATRËS ATDHETARË TË SHQIPTARIZMËS

Vlora e flamurit dhe Pavarësisë, simbolikës së qëndresës e mbijetesës ndaj pushtimeve ishte në ballë edhe në luftën e madhe antifashiste. Bijtë e bijat e saj shkruan epope mençurie dhe trimërie përballë fashizmit italian që më 1920-tën. Në Vlorë bazat e sigurta antifashiste sikurse janë të dokumentuara, që shkojnë në më shumë se 350 shtëpi baza lufte, nga të cilat po përmendim disa prej tyre Familja Bule Imami, Fadil Dauti, Xhavit e Qemal Mehmeti, Jani dhe Aspasi Mandro, Shaqo e Toli Arapi, Mitat e Lef Sallata, Shefqet Veshi, Shefqet Cenko, Ervehe Gorishti, Hyrie Drenova nëna e tre vajzave partizane të Ylvies, Hanës dhe Faries, Stoli e Sali Bahaj, Teme Alushi, Bexhet Zyberi, Petrit Bisha, Ruhije Zahaj, Ymer Picari, Shefqet Resuli, Hajro Çakërrri, Emine Çela, Faik Imeraj, Namik Xhafa, Osmën Xhemali, Sezai Agalliu, Rexhep e Nuri Arapi nga ku kanë dalë nëntë partizanë, Hamza Xhuka nga Peja, që i dha luftës 4 partizanë e partizane, Dushan Aliko, Riza Taushani, Xhevit e Qemal Malaj Zyra Radhima, Hasan Doçi, Dalip Sako dhe shumë të tjera.

Gjeneral Rrahman Parllaku në librin "Mirënjohje familjeve vlonjate, që më mbajtën si birin e tyre", Tiranë, 2007, faqe 158-159 shkruan: "...nga kujtimet me familjen e Jani dhe Aspasi Mandros. Xha Jani, bashkë me një ortak merrej me tregëti. Familja e tij bënte një jetë qytetare të rregullt, edukonte e shkollonte fëmijët e ndër tyre ...Dhimitrin, Cien (Anastasia). Nënë Aspasia kur ishte martuar me Xha Janin, ja shtuan gjallërinë oxhakun "Mandro".. kjo familje jetonte në harmoni të plotë. Nënë Aspasia fëmijët i kishte në luftë, por kujdes të veçantë tregonte për vajzën Cien. Familja e xha Janit ishte streha e përhershme e njësiteve guerile...". Bazat e LANÇ-it janë plotësisht të dokumentuara tek Muzeu historik i luftës në Vlorë. Shtëpia e Jani Mandros ishte me dy kate, ndërsa kati i dytë shërbente si bazë ku përgatiteshin komunikatat dhe thirrjet për luftë kundër fashizmit, ishte bazë e sigurtë e njësiteve guerile, ndërkohë që shumë shtëpi fqinje të lagjes". Në fillim të vitit 1942 u krijuan dy njësite guerile që ishin skelet i ushtrisë së ardhëshme të çetave partizane në trevën vlonjate. I pari me Arif Haskon, "Patrioti" dhe pjestar Et'hem Gjinushi "Goliku", Vëhbi Hoxha, Koço Kllapi, Shyqyri Alimerko, Teli Ndini, Rrahman Parllaku, Dhimitër Mandro; ndërsa i dyti, i rinisë me përgjegjës Hito Çako, Babaçe Faiku, Ismet Çakërrri, Fadil Dauti, Hidai Bejo, Kristaq Çali, Shaqo Arapi, Hajredin Bylyshi, Mumin Selami, Barjam Tushi, Hiqmet

Buzi. Organizimi i parë i demonstratës së bukës ishte më 9.3.1942, që udhëhiqej nga Komiteti Qarkor i Vlorës dhe Hysni Kapo. Si në gjithë luftat për liri edhe gjatë LANÇ-it Vlora, bijtë dhe bijat e saj i dhanë impulse të fuqishme lirie si një ndër trevat më të përgjakshme të vendit ku në tërësi Zona e Parë Operative me aktivitet në mbi 6000 km² ka dëshmorët më të shumtë të rënë në luftë për çlirim, prandaj dëshmorët dhe gjithë antifashistët që rrokën armët gjatë LANÇ-it meritojnë nderimin e mirënjohje mbarëkombëtare.

ANASTASIA (CIA) MANDRO ME ARMË NË DORË PËR LIRINË E ATDHEUT

Anastasia (Cia) Mandro ishte lindur më 12 të Vjeshtës së Parë (shtator) të vitit 1923 në qytetin e Vlorës në lagjen e vjetër dhe të njohur "Muradije". Edhe pse emri i saj ishte "Anastasia" që do të thotë "ringjallje", por që babai ja vendosi për ringjallje të shqiptarizmit, pasi ajo erdhi në jetë në kohë të vështirë. Anastasinë pushtimi i 7 prillit 1939-ës e gjeti në moshën 16 vjeçare. Ajo nuk pranonte përkëdhelitet prindërore përpara robërimit fashist. Kështu që nuk kishte më fëmijëri për të dhe për dy vëllezërit më të mëdhenj dhe një vëlla më të vogël. Oxhaku "Mandro" ku erdhi në jetë Cia ishte një vatër e ngrohtë atdhetarie e patriotizmi, me prindër që gëzonin respekt në mbarë qytetarinë vlonjate, me trashëgimi të spikatur për atdhedashuri dhe përkushtim në breza, bashkë me familjet e tjera me rrënjë vlonjate. Fëmijërinë e shkoi në shkollën qytatase ku ishte e etur për dritë diturie dhe shquhej për rrezultare shumë të larta dhe kjo u vërtetua që edhe shkollimi i saj ishte tepër cilësor por pas lufte dhe sidomos pas shërimit të dy plagëve të marra në luftën antifashiste partizane. Shkollimi i saj u ndërpre për shkak të luftës dhe shkolla e luftës për Cian ishte më shumë se një universitet. Cia Mandro kishte marrë pjesë bashkë me vëllezërit në njësitet guerile të qytetit të Vlorës. Aktiviteti i tyre kulmoi me pjesëmarrjen masive për demonstratën e bukës më 9.3.1942. Cia ishte pjesëmarrëse bashkë me vëllezërit e saj në përlëshjen me milicët fashistë më 7.8.1942 te sheshi Flamerko, ku vritet antari i njësiteve guerile Teli Ndini duke shpërndarë trakte; por dhe hedhja në erë e depove në Radhimë me dinamit më 9.8.1942 nga Shyqyri Alimerko, duke e ndezur me fitil e eshkë ishte fryt i punës aktive të njësiteve guerile, ku bënte pjesë edhe Cia Mandro familjarisht. Në kohën kur lufta çlirimtare kishte marrë hov të madh dhe pushtuesi kishte hëngër grushte të fuqishëm nga formacionet e porsakrijtura partizane edhe në qytet për motër e vëlla për Cian dhe Dhimitrin ishte "mbushur kupa" dhe nuk mund të qëndronin më në ilegalitet. Rruget e lavdishme partizane ishte plotësisht e hapur për ta. Ndër misionet vendimtare në qytetin e Vlorës ishte rrëmbimi i shtypshkronjës dhe dërgimi i saj në një zonë të sigurtë, një veprim plotësisht i organizuar dhe koordinuar ku morën




pjesë vëlla e motër Dhimitër e Cia Mandro. Në rreshtat partizane Anastasia (Cia) Mandro gjeti mjaft shoqe të idealit, antifashiste të vendosura sikurse ishte Zonja Çurre dhe shoqe të tjera të saj si: Hanko Muço, Jeta Veshi, Afërdita Thanasi, Inajete Ramadani, Rana Thani, Gjena Shanko, Hyrvete Halimi, Donika Çakërrri, Naile Ferra, Stoli Xhemali, Kanerina Sulo, Liri Aranitasi, etj. Ishin mbi 50 gra e vajza partizane vlonjate dhe nga gjithë Labëria. (Historiku BrVS, Tiranë, 1989, faqe 129). Në rreshtat partizane publikuan "Buçitja" (1944) e Brigadës V Sulmuese, një gazetë e zjartë antifashiste. Në një prej luftimeve të Brigadës trimëresha dhe vajza guximtare e Vlorës mori dy plagë të rënda por me barrel u transportua në Bregdet dhe prej andej me anijet e aleatëve drejt Barit, ku ishte instaluar Shtabi Aleat i Mesdheut që mbështeste luftën tonë. Doktorët e shpëtuan nga kthetrat e vdekjes Cia Mandron, për të jetuar gjatë dhe për të shërbyer denjësisht shtetit të ri shqiptar të pas luftës.

Atje në Bari mësoi edhe për vrasjen e shoqes së saj të ngushtë Zonjës, bijës së Arif dhe Salihe Çurre. Më 22.7.1944, kur Brigada e saj zhvillonte luftime të ashpra dhe batalioni i katërt luftonte në Qafë Shkallë të Klosit në këto luftime ra Zonja Çurre, një trimëreshë dhe shoqe e betejave të panumërta partizane. Për luftimet e përgjakshme të Qafë Shkallë të Klosit, ku ra heroikisht Zonja Çurre, lajmi në Bari të Italisë për Cian ishte një moment i prekshëm dhe i dhimbshëm, që po i shkëputej një copëz e shpirtit, por e ngushëltonin ditët e lirisë që po afronin për Atdheun. Anastasia u kthye në Vlorë bashkë me lirinë plotësisht e shëruar, e gatshme për përgjegjësi të reja. Kur përmendim emrin e Cia dhe Dhimitër Mandro si emra mjaft të njohur në Vlorë, menjëherë kujtojmë teknikën e shtypit, shtypshkronja dhe shtypshkrimet, propaganda aq e nevojshme gjatë luftës, për Brigadën e Pestë Sulmuese dhe gazetën e saj gjatë luftës "Buçitja". Ata ishin në radhët e para të luftës në rreshtat partizane, në Vlorën heroike dhe në brigadën heroike "Hero i Popullit". Publikimet për këtë grua janë të pakta, por kujtohet nga publikimi i ing. Anesti Çaushtit në gazetën "Intervista" më 6.12.2014 (nr.1083), ku flet për familjen e Jani Mandros në lagjen "Muradije",

106 VIETORI

Ngjarje vendimtare për shpëtimin dhe ringritjen e shtetit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore

Kongresi i Lushnjës janar 1920 dhe roli i konsullit britanik Morton Frederik Eden



tij tregon se konsulli Morton Eden fliste hapur me nacionalistët shqiptarë për dëbimin e italianëve dhe zhvillimin e një kongresi kombëtar. Ai e kishte prituri konsullin në shtëpinë e tij. Në një dorëshkrim të Ahmet Shehut që ruhet në Shtëpinë Muze të Kongresit të Lushnjës jepen të dhëna për një takim të konsullit Eden në Teqenë e Karbunarës ku foli për nevojën e një kongresi kombëtar pasi sipas tij pavarësia e Shqipërisë ishte në rrezik. Pas marrjes së vendimit për mbajtjen e kongresit në Lushnjë, Eden shkoi në Peqin, Tiranë, Mat dhe Shkodër.

Gjatë udhëtimit për në veri ku shoqërohej nga Preng pasha ai u plagos, por nuk e përhapi lajmin se kjo do ta dëmtonte misionin e tij. Në Kongresin e Lushnjës ai merr pjesë së bashku me kolonelin britanik Philips. Ndërkohë, Qeveria e Durrësit, e mbështetur edhe nga forcat ushtarake italiane, u përpoq me çdo mjet të pengonte zbatimin e vendimeve të Kongresit të Lushnjës. PPërballë presioneve dhe kërcënimeve të armatosura, disa delegatë nga Tirana, Elbasani, Kavaja dhe Shijaku shprehën mendimin që të qëndronin përkohësisht në Lushnjë, nga frika e sulmeve të mundshme nga forcat italiane, të nxitura nga qeveria e Durrësit. Në detyrën e Ministrit të Brendshme, Ahmet Zogu luajti një rol të pazëvendësueshëm në vendosjen e rendit dhe autoritetit shtetëror në një Shqipëri të trazuar. Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës u vendos në Tiranë dhe që nga ai moment, Tirana mbetet kryeqytet i Shqipërisë.



• **Organizimi i kongresit ishte një veprimtari politike me karakter kombëtar, por nuk flitet sa duhet për faktorin ndërkombëtar dhe konkretisht për rolin britanik, veçanërisht të konsullit britanik Morton Eden**

Nga Sakip Cami

Kongresi i Lushnjës është ngjarja më e madhe dhe vendimtare për shpëtimin dhe ringritjen e shtetit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore. Historiografia shqiptare e paraqet me të drejtë Kongresin e Lushnjës si sukses i politikës shqiptare të kohës, por duhet nënvizuar fakti se ky sukses erdhi pas një lufte të ashpër politike midis dy grupeve rivale politike, midis grupit të Esat pashë Toptanit dhe të Qeverisë së Durrësit dhe grupit të politikaneve patriotë e mendjendritur të kryesuar nga Aqif pashë Elbasani (Biçakçiu), Ahmet Zogu, Sulejman Delvina etj.

Organizimi i kongresit ishte një veprimtari politike me karakter kombëtar, por nuk flitet sa duhet për faktorin ndërkombëtar dhe konkretisht për rolin britanik, veçanërisht të konsullit britanik Morton Eden.

Qeveria Britanike nuk ishte dakord me praninë e trupave italiane në Ishullin e Sazanit dhe në qytetin e Vlorës, nuk ishte dakord me politikën nënshtruese të Qeverisë së Durrësit ndaj italianëve, nuk ishte dakord me kërkesat ekspansioniste të Serbisë dhe të Greqisë për zgjerim të tyre në dëm të Shqipërisë, prandaj përkrahu mbajtjen dhe vendimet e Kongresit të Lushnjës dhe ndikoi nëpërmjet konsullit të saj Morton Eden. Mbështetës për organizimin e Kongresit të Lushnjës ishin edhe ministrat e qeverisë së Durrësit, që morën pjesë në Konferencën e Paqes në Paris Mehmet Konica, Mihal Turullli dhe imzot Liugi Bumçi, të cilët u takuan në Paris edhe nga konsulli i Anglisë Morton Eden.

Eqerem Bej Vlora që ishte kundër zhvillimit të Kongresit në kujtimet e



POEZI NGA SAKIP CAMI

NË SE SKËNDERBEU...

Në se Skënderbeu ka të
Malet zhveshin tërë gjithimin
e me të e mbulojnë.
Në se Skënderbeu ka
Pyjet fëshfërijnë e ia
freskojnë ballin.
Në se Skënderbeut i pihet
Gurrat çahen te këmbët e tij
e gurgullojnë
Në se Skënderbeu do të flejë,
Toka dhe nëntoka heshi.
Në se Skënderbeu do të
Dritaret hap pranvera e
zemrave të ushtarëve.

ANASTASIA (CIA) MANDRO, VLONJATJA E HEKURT ANTIFASHISTE

Vijon nga faqja 8

për fëmijët që merituan emrin e ndritur të antifashistëve që lanë emër të shquar të luftëtarëve të LANÇ-it në Brigadën e Pestë Sulmuese. Anastasia është nderuar me dhjetra dekorata, medalje e urdhëra të luftës dhe të punës si dhe më 2025 për të përjetësuar kujtimin e kësaj gruaje të hekurt antifashiste është realizuar një bust në bronz, nga artisti gjirokastrit nga Picari Emanuel Koko, një punim mjeshhtëror, që ka derdhur talentin plot vërtetësi dhe objektivitet. Pavarësisht shoqëron gjithë kontribuesit e kombit shqiptar.

BURIMET E STUDIMIT: Të dhëna arkivore si dhe nga zyrat e Organizatës së Dëshmorëve dhe të Veteranëve në Vlorë dhe në Tiranë; të dhëna nga Periodiku i gazetave në Bibliotekën Kombëtare, gazeta "Korieri", "Telegraf", "Ndryshe", "National", "Kushtrim Brezash", Revista "Pavdekësia", gazeta

"Labëria", gazeta "Zëri i Vlorës", gazeta "Fushëbardha" për formacionet luftarake partizane në Labëri; Materiale nga seria "Yje të Pashuar" të shkrimtarit Resul Bedo, nga shkrimtari Qamil Buxheli, Andrea Varfi, "Dita" Mbi vrasjen e Ali Demit "Hero i Popullit", të dhëna nga libri Historiku i Brigadës V Sulmuese, Tiranë, 1989, hartuar nga një grup ish-luftëtarësh të BRVS; të dhëna historike nga Departamenti i Historisë në Akademinë e Forcave të Armatosura; Kujtime nga LANÇ-it, "Populli na ndihmoi për funksionimin e shtypshkronjës partizane" të shkruar nga veterani i LANÇ Qazim Skëndero Nanaj; Zaho Golemi, Vështrim mbi organizimin dhe ndihmesën e formacioneve me ushtarakë të huaj në radhët e Ushtrisë NÇ Shqiptare (UNÇSH) dhe "Aleatët anglo-amerikanë në vendin tonë gjatë periudhës së Luftës, 1943-1946"; Dhimitër Mandro, Aspekte të krizës së sotme në...", Red. Lulzim Hana; redaktori: Harilla Papajorgji, Elmaz Bimi, Tiranë, 1979; Bexhet Rrapaj;

Shkëndijat e para të LANÇ-it, lufta ilegale dhe guerilase, sipas gazetës "Telegraf", datë 1.11.2023; Filip Rrumbullaku, Dekorimet nga Princ Vidi deri më sot, Tiranë: SHB "Onufri", faqe 283; Hiqmet Zane, gazeta "Dita" më datë 28.9.2020; të dhëna nga "Misioni ushtarak shqiptar, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Aleate të Mesdheut në Bari", që veprimi nga korriku 1944 (fillimisht 4 shqiptarë) deri më qershor 1946 (misioni kishte 33 vetë në fazën përmbyllese) dhe nga drejtuesit shqiptarë kanë qenë fillimisht Bedri Spahiu dhe më vonë Kadri Hoxha; të dhëna nga arkivi familjar; Anesti Çausi, gazeta "Intervista" në kujtim të Cia Mandros, më 6.12.2014 (nr.1083), të dhëna dhe foto nga arkivi familjar, "Historiku i grave dhe vajzave të Vlorës gjatë LANÇ-it", (hartuar nën drejtimin e ish-komisarit të BrVS Hysni Kapo, viti 1969 në kuadrin e evidentimit dhe krijimit të historikëve të formacioneve të mëdha të LANÇ-it.

PERSONAZH

Kalvari i burgjeve të diktaturës i ish - partizanit trim, Sekretar i Këshillit Nacionalçlirimtar të Qafë Murrës

SALI DUKA, ANTIFASHISTI, EMBLEMË E DISIDENCËS

- *Rasti i tij është krejt i veçantë në historinë e të burgosurve politike të regjimit diktatorial. Pas arrestimit nga ata që abuzonin se vepronin “Në emër të popullit” është bërë shtatë herë gjyq. Dhe me akuza të sajura, nga seanca në senacë vijnë dënimet e ashpra: me pushkatim, me varje, me 100 vite burg, me burgim të përjetshëm, me 37 vite burg, me 25 vite dhe përfundimisht me me 15 vite heqje e të drejtave elektorare i shpallur armik i popullit (kulak)....*

Halil Rama – Mjeshtër i Madh

- *Për emrin dhe kalvarin e këtij disidenti të regjimit komunist gjithkush mund të mësoj edhe nga vizita në skutat e errëta të famëkeqes Shtëpia e Gjetheve ose siç quhet zyrtarisht Muzeu i Mbikëqyrjes Sekrete, i njohur edhe si një muze historik në Tiranë....*

Në faqen e tij zyrtare në facebook, poeti, studiuesi dhe esseisti i njohur Isuf Miha ka një rubrikë interesante: “Personalitete që kanë bërë emër në krahinën e Katër Grykëve të Dibrës”, disa prej të cilëve kontributorë të çështjes kombëtare shqiptare. Dhe nuk është rastësi, që përveç klerikut të njohur Hoxhë Bodini (Sefer Bodini) që dha jetën për atdhe; Llan Des-tan Ndregjonit, burrit që ngrii flamurin shqiptar në Kuvendin e Arrasit ku u iniciua kryengritja dibrane për shporrjen përfundimtare të pushtuesve serbë nga trojet shqiptare; Tafë Kaziut; Hoxhë Bajram Bucit (Mullà Bajrami), teologu, ideologu, luftëtari dhe martiri i Rilindjes Kombëtare Shqiptare; Jashar Lelës etj, rendit edhe Sali Demir Dukën, dibranin që s’u tremb nga e vërteta, duke qëndruar stoik ndaj gjyqeve speciale dhe dënimeve të njëpasnjështe në gjyqet e montuara politike.

Ai ka hyrë në analet e historisë sonë kombëtare si burri trim e i mençur, që ashtu siç luftoi trimërisht me armë në dorë kundër pushtuesve nazifashistë, po me stoicizëm i rezistoi edhe diktaturës komuniste të pasçlirimit të atdheut, që i trembej personaliteteve si ai. Madje, për emrin dhe kalvarin e këtij disidenti të regjimit komunist gjithkush mund të mësoj edhe nga vizita në skutat e errëta të famëkeqes “Shtëpia e Gjetheve” ose siç quhet zyrtarisht Muzeu i Mbikëqyrjes Sekrete, i njohur edhe si një muze historik në Tiranë.

Saliu lindi në Qafë Murrën e Katër Grykët e Dibrës, aty ku gurët flasin për trimëri dhe era pëshpërit për nder. Këtu jetoi Sali Duka dhe mbeti një ndër burrat më të ditur dhe më të ndershëm të asaj treve legjendare.


Bashkohësit e kujtojnë si burrë me zemër prej drite, që jetoi me parime e me karakter të fortë.

ISHTE NDËR PJESËMARRËSIT AKTIV NË ÇETËN PARTIZANE TË DIBRËS

Sali Demir Duka u lind në Qafëmurrë, më 27.06.1926, në një familje të thjeshtë fshatare. Ai ishte djali i fundit i familjes të madhe me 5 vëllezër dhe 4 motra. Që në fëmëri u shqua për një inteligjencë natyrale.

Në vitin 1934 fillon shkollën që u hap për herë të parë në Murrë.

Duke e vlersuar si djalë të shkathët dhe inteligjent, komandanti i Çetës Antifashiste të Dibrës Hax-



hi Lleshi e fton të bëhet pjesëmarrës në të, me një letër dërguar me korier ku i shkruan:

“Miku im Sali Duka, të pres në çetën time. Të dua në krahun tim. Nuk besoj se nuk do duash të jesh në krahun tim. Mirse të vish. Ne jemi shpëtimtarët e Shqipërisë. Vdekje fashizmit, liri e popullit”.

Saliu, i rritur dhe edukuar me ndjenja atdhetare, asokohe i bindur se çlirimi i vendit nga okupatori fashist ishte detyrë atdhetare, i beson Haxhi Lleshit duke u angazhuar në Çetën e Dibrës, ku mori pjesë aktive dhe luftoi me trimëri të rrallë në të gjitha aksinet e kësaj çete partiazne, nga viti 1942 deri në korrik 1944. U Largua nga radhët e saj, menjëherë

pas vrasjes të vëllait Rustemit.

Në vitin 1945 u zgjodh sekretar i Këshillit Nacionalçlirimtar të fshatit. E kreu këtë detyrë me drejtësi e përkushtim ndaj bashkëfshatarëve, në bashkëpunim me kryetarin e këshillit Selman Shehu, edhe ky një personalitet emërndritur nga një familje po e tillë e Qafë Murrës së katër Grykëve të Dibrës.

I BESOI HAXHI LLESHIT, POR DIKTATURA JA MOHOI KONTRIBUTIN NË LANÇ DHE E DËNOI ME AKUZA ABSURDE

Nëse i besojnë postulatit se “Diktatura ha bijtë e vetë”, shembullin më sinjifiktaiv e gjejmë edhe në personalitetin e Sali Demir Dukës të Qafë Murrës. Kur ende nuk ishin tharë plagët e luftës çlirimtare në të cilën ai dha kontribut evident, në vitin 1946 e arrestojnë me akuzën absurde për “agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor” dhe për “bashkëpunim me bandën e armikut të popullit, kriminelit Gjon Markagjonit duke kryer krime kundër partisë e shtetit”.


Rasti i tij është krejt i veçantë në historinë e të burgosurve politike të regjimit diktatorial. Pas arrestimit nga ata që abuzonin se vepronin “Në emër të popullit” është bërë shtatë herë gjyq. Dhe me akuza të sajura, nga seanca në seancë vijnë dënimet e ashpra: me pushkatim, me varje, me 100 vite burg, me burgim të përjetshëm, me 37 vite burg, me 25 vite dhe përfundimisht me me 15 vite heqje e të drejtave elektorare e shpallur armik i popullit (kulak).

Vendimi përfundimtar është marrë nga Gjykata Ushtarake e Elbasanit pa asnjë dëshmitar konkret por vetëm me opinionin e seksionit, pra pa asnjë provë. Ky Dënim ishte thjeshtë për inteligjencën e tij brilante. Kreu 9 vite dhe u lirua.


Kështu e pësoi Sali Duka, ish partizani trim i çlirimit, njeri i fjalës së drejtë dhe i besës shqiptare. Ndonëse në rininë e tij i besoi Haxhi Lleshit dhe u rreshtua me çetën e tij antifashiste, provoi kalvarin e rëndë në hetuesitë speciale të diktaturës. Dhe për mendimin e lirë e për guximin për të thënë të vërtetën, nuk e kurseu as koha e pasluftës, me padrejtësitë e saj. Por gjithsesi, as burgjet, as presioni nuk arritën ta përkulnin. Ai qëndroi si lis në furtunë, krenar, i heshtur, por i pathyeshëm.

PERSONALITET I RRALLË QË MERITON RESPEKTIN E ÇDO BREZI

Sali Duka ndërroi jetë para 30 vitesh, por emri i tij nuk u harrua. Ai mbetet simbol i qëndresës, i burrërisë dhe i urtësisë dibrane. Djali i tij, Rustemi që ka sdudjuar për pikturë dhe muzikë, tashmë në emigracion në Francë, me krenari legjitime thotë se “Në çdo kujtim për babain, ndjejmë aromën e nderit dhe frymën e Atdheut”. Ndërkohë një falenderim i veçantë shkon për poetin, esseistin dhe studiuesin skurpuloz Isuf Miha, që mundësoi këtë fotografi të rrallë, duke risjellë në kujtesë figurën e këtij burri të rrallë, që meriton respektin e çdo brezi. Lavdi kujtimit të Sali Dukës, burrit që e nderoi Dibrën me veprën, fjalën dhe qëndresën e tij.



Rustem Duka



HISTORIA

RAMICA - BAZË E LANÇ-it NË QARKUN E VLORËS



Prof. asoc. Bernard ZOTAJ – Mjeshtër i Madh

BAZË E SHTABEVE USHTARAKE

Gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, populli i fshatit Ramicë, në Qarkun e Vlorës, u shndërrua në një nga bazat më të rëndësishme dhe më të qëndrueshme të luftës çlirimtare. Ky fshat malor, i frymëzuar nga ndjenjat e thella patriotike dhe dashuria për Atdheun, dha një kontribut të jashtëzakonshëm për fatet e vendit gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke vënë në shërbim të luftës gjithçka kishte më të shtrenjtë, deri edhe jetën.

Ramica shërbeu jo vetëm si Zonë e Lirë e LANÇ-it, por edhe si pikë dominuese strategjike, falë terrenit të saj të favorshëm, i cili lehtësonte drejtimin operativ dhe strategjik të veprimeve luftarake në gjithë zonën e Lumit të Vlorës. Nga kjo zonë u organizuan dhe u zhvilluan luftime të rëndësishme, veçanërisht gjatë Operacionit të Dimrit 1943–1944, si dhe gjatë gjithë gjashtëmujorit të parë të vitit 1944.

Ramica u bë seli e shtabeve partizane të Qarkut të Vlorës, si dhe e disa brigadave të rëndësishme, si Brigada V Sulmuese (BrVS), Brigada I Sulmuese (BrIS), Brigada VI Sulmuese (BrVIS) dhe Brigada XII Sulmuese (BrXIIS), përveç çetave dhe batalioneve partizane. Populli i Ramicës i strehoi, i ushqeu, i veshi dhe i mbathi partizanët, duke dëshmuar solidaritet të lartë dhe një frymë të rrallë humanizmi. Në Ramicë u hap dhe funksionoi spitali partizan i Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër, i vendosur në shpellën e Hyse, ndërkohë që shumë familje ramiciote strehuan dhe mjekuan partizanë të plagosur.

Në këtë fshat gjetën mbështetje dhe zhvilluan veprimtarinë e tyre, si ilegalë dhe legalë, figura të shquara të LANÇ-it, si: Hysni Kapo, Mehmet Shehu, Ali Demi, Manush Myftiu, Pajo Islami, Shefqet Peçi, Haki Toska, Liri Gega, Liri Arapi, Teli Nдини, Ymer Veshi, Ramize Gjebreja, si dhe dhjetëra të tjerë. Që nga tetori i vitit 1943 e deri në çlirim, në Ramicë u vendosën dhe punuan Qarkori i Partisë për Vlorën, Komanda e Qarkut, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Qarkut, Shtabi i BrVS dhe Shtabi i BrVIS.

Në historikun e fshatit, por edhe në lapidarin përkujtimor, roli i Shtabit të BrVIS nuk është pasqyruar në masën e duhur. Komanda dhe shtabi i kësaj brigade, me komandant Tahir Kadarenë dhe komisar Haki Toskën, u vendosën në shtëpinë e Hodo Feratit. Nga Ramica u nisën gjithashtu delegatët e Qarkut të Vlorës për në Kongresin Antifashist të Përmetit (maj 1944) dhe delegatët e rinisë an-

- *Ramica u bë seli e shtabeve partizane të Qarkut të Vlorës, si dhe e disa brigadave të rëndësishme, si Brigada V Sulmuese (BrVS), Brigada I Sulmuese (BrIS), Brigada VI Sulmuese (BrVIS) dhe Brigada XII Sulmuese (BrXIIS), përveç çetave dhe batalioneve partizane. Populli i Ramicës i strehoi, i ushqeu, i veshi dhe i mbathi partizanët, duke dëshmuar solidaritet të lartë dhe një frymë të rrallë humanizmi*

tifashiste për në Kongresin e Helmësit (gusht 1944).

KONTRIBUTI I POPULLIT TË RAMICËS NË LUFTË

Më 28 nëntor 1942, në Prrallin e Verbasit, në Ramicë u zgjodh pushteti popullor, i përfaqësuar nga Këshilli Antifashist i fshatit. Deri në çlirim, në Ramicë u zhvilluan mbi 30 veprimtari masive me karakter informues, sqarues dhe vendimmarrës, në sheshe, shtëpi dhe livadhe.

Mbi 10 shtëpi u vlerësuan si “Baza të Luftës”. Ndër to përmenden shtëpitë e Zenel Hasan Currajt, Gilo Lame Sulçajt, Dervishajve, Zoto Rakip Zotajt, Caneve, Pronjeve, Lavdosh Zaçe Zotajt, si dhe Feti e Faik Liçajt.

Mbi 70 djem dhe vajza të Ramicës u rreshtuan në njësitet partizane, kryesisht në BrVS dhe BrXIIIS. Mbi 50 të tjerë u angazhuan në çetën vullnetare territoriale të fshatit, e cila mori pjesë në të gjitha luftimet deri në çlirimin e Vlorës. Rreth 70 gra ramiciote kontribuuan në mënyrë të veçantë në ndihmë të ekonomisë partizane. Populli i Ramicës përballoi me vetmohim pesë operacionet e mëdha armike që kaluan në krahinën e Mesaplikut, duke përjetuar shkatërime, uri dhe humbje të rënda. Bilanci i luftës ishte i dhimbshëm: 25 dëshmorë, ndër ta partizania Rakibe Dervishaj dhe dëshmoret Hajdine Zoga, Sartë Gabaj e Rubie Bocaj; 10 të plagosur, të internuar e të burgosur; 70 shtëpi të djegura dhe rreth 2 000 krerë bagëti të imta të shkatërruara.

Nga radhët e ramiciotëve dolën shumë koman-

dantë dhe komisarë, të cilët pas çlirimit u bënë kadro e specialistë të aftë në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, ekonomike dhe ushtarake, si: Mevlan Dervishaj, Pajo Islami, Bako Dervishaj, Moisi Elezi, Bardhosh Halimi, Lavdosh Zotaj, Njazi Canaj, Shyqyri Ajazi, Gilo Lame, Hasan Abedini, Ismail Burhanaj, Fato Zotaj, etj.

SHEFQET PEÇI DHE RAMICA

Një nga figurat më të shquara të LANÇ-it, që u lidh ngushtë me Ramicën, ishte Shefqet Peçi. Ai njohu nga afër trimërinë dhe sakrificat e popullit të këtij fshati dhe i përjetësoi ato në këngë dhe shkrime. Shefqet Peçi vendosi shtabin e tij në Ramicë, ndërsa Shtabi i BrVS kishte rezidencën në shtëpinë e Zotajve. Bashkëpunimi i tij me Hysni Kapon dhe kuadrot partizane forcoi më tej organizimin dhe moralin luftarak.

RAMICA DHE URDHRI I FLAMURIT

Për kontributin e jashtëzakonshëm në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, fshati Ramicë u dekorua me “Urdhrin e Flamurit”. Më 14 nëntor 1945, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar mori vendimin për dekorimin e Ramicës me këtë dekoratë të lartë, si shenjë mirënjohjeje për heroizmin, sakrificat dhe qëndresën e popullsisë së saj, e cila mbajti në gjirin e vet partizanë, përballoi operacione të rënda armike dhe sakrifkoi pasurinë dhe jetën për lirinë e Atdheut.



REFLEKSIONE

Rreth librit të Prof. dr. Irakli Koçollari "Operacione sekrete"

SHQIPËRIA NË VORBULLËN E LUFTËS SË FTOHTË

• "Spiunazhi është art i vështirë, vërtet i vështirë: nuk ka situatë në të cilën ky art nuk përdoret".

Sun Tzu



SHPENDI TOPOLLAJ

Koha e gjatë që ka kaluar qysh kurse u artikuluua dhe nisi të vihet në zbatim termi "Lufta e Ftohtë", ka bërë që për ne shqiptarët, kuptimi i saj të reduktohet dhe të ndalet te togfjalëshat "Gara e armatimeve", "Mbushjet bërthamore" dhe "Lufta e Yjeve". Thuajse u harrua ajo ndeshja e rreptë e organeve tona të sigurimit me planet dhe veprimtarinë e pareshtur agjenturore të shërbimeve të huaja të fshehta. Ndofta, këtu ka ndikuar edhe mospasja e një përshkrimi të hollësishëm dhe plotësisht e shkencërisht të dokumentuar, pasi kanë munguar hulumtimet nëpër arkivat e vendeve të tjera, të cilat ruajnë sekretin me ligje të posaçme, dhe që kërkojnë një kohë të tejzgjatur për t'i njohur. Kështu, që jemi mjaftuar me kujtimet e ndonjë protagonistit të atyre ngjarjeve apo të ndonjë filmi të bërë për këtë qëllim. Shtu pastaj,

që të gjitha përpjekjet, mudi e sakrificat e bëra me aq durim e mençuri u çvleftësuan, kur Enver Hoxha me megallomani dhe keqdashje deklaroi se të gjitha grupet armiqësore i ka zbuluar Partia, dhe për pasojë ministrat përkatës u shkuan në plumb. Por ja ku, pas një pune të jashtëzakonshme studimore, profesor Irakli Koçollari vjen për ta mbushur këtë boshllëk me librin e tij dy volumësh "Operacione sekrete" (Shqipëria në Luftën e Ftohtë). Ky autor, pas një përvoja vetjake dhe shkruarjes së një sërë librash të kësaj natyre, ku dallojnë "Spiunazhi në shekuj" dhe "Policia sekrete e Ali Pashës", libra që janë pritur me një interes të veçantë, por edhe me nivelin e kulturës dhe erudicionit të tij, pa folur për vullnetin titanik, ndoshta është pena më e saktë dhe më e besueshme për të trajtuar një tematikë të tillë e cila bëhet edhe delikate po të kemi parasysh kohën që jetojmë. Është e çuditshme po ta mendosh, përse u zgjodh pikërisht Shqipëria e vogël, e varfër dhe e shkatërruar, si për të nisur, në një farë kuptimi, Luftën e Dytë Botërore, atë 7 Prill të vitit 1939, edhe si objektivi kryesor dhe i pari për të nisur goditjen ndaj Bllokut të ashtuquajtur Komunist. Mbi vendin tonë aso kohe u kryqëzuan disa lloj interesash, ku perëndimorët, e kryesisht SHBA dhe Britania kishin si synim rrëzimin e qeverisë pro sovjetike dhe shkapëputjen e Shqipërisë nga influenca e Stalinit, kurse fqinjët kërkonin të realizonin ëndrrat e vjetra shoveniste. Por për hir të së vërtetës, autori i librit, me fakte dhe pohime të pakundërshtueshme, na

tregon se veçanërisht SHBA, asnjëherë nuk kanë mbështetur kërkesat e tyre për copëtimin e trojeve tona, duke dashur edhe stabilitetin e Ballkanit. Ashtu sikurse në kohën e Presidentit Wilson, ata, edhe në Planin e tyre "BG-FIEND" dhe në të gjitha takimet agjenturore dhe diplomatike, kanë qenë të palëkundur përse i takon ruajtjes së tërësisë tokësore të vendit tonë. Veç duhet vënë në dukje se CIA, nga ana e saj, nuk kishte njohjet e duhura për realitetet e pasluftës në Shqipëri dhe nuk dihet pse ajo nuk përfshiu në realizimin e synimeve të saj, ata oficerë që kishin qenë këtu gjatë luftës, gjë që e ata të Secret Inteligent Service britanik e bënë, sidomos për përgatitjen e emigracionit dhe ndjekjen e operacioneve të tyre sipas Planit "VALUABLE" nga ana e MI6. Mirëpo, në ato vite, Shqipëria kalonte edhe vështirësi të mëdha politike, pasi pas letrave të Informbyrosë, kishte nododhur prishja me PKJ të Titos, të cilit vetë Enveri i lutej ta përfshinte Shqipërinë si republikë të shtatë. Irakliu qysh në fillim na jep një panoramë të qartë, jo vetëm përse ngjet te ne, por edhe mes dy sistemeve, atij kapitalist dhe atij komunist. Ja si shkruan ai: "Kështu vazhdoi kjo "Luftë"...për dekada me radhë duke mbajtur familje, individë, popuj të tërë, të njohur apo anonimë, nën tensione, ankth, pritmëni, armiqësi, lot e dhimbje. Të gjithë ata mbetën larg njëri - tjetrit, madje në dy kampe, përballë një çarku të ngehur dhe kërcënues, ku një shkrepje e mundshme mund të vinte palët kundërshtarë, Lindjen me Perëndimin, në një krahurë apo kasaphanë të paimagjinueshme". Dhe në funksion të këtij qëllimi, perëndimorët e at'herëshëm, zgjodhën taktikën e goditjes në pikën më të dobët, pra, për ta bërë Shqipërinë nëpërmjet revoltave të brendshme dhe sulmit gjoja të përligjur, si ndihmë nga jashtë, shembullin për ta shpënë deri në fund atë që dëshironin. Dhe për këtë, u angazhuan edhe udhëheqësit kryesorë të këtyre shteteve, ashtu sikurse për vendin tonë u ngarkuan me këtë detyrë, mendjet më të sofistikuar, pra specialistët më të shquar, si fjala vjen Ciceroni (Borton Yost Berry), e Horaci (Robert G. Miner). Dhe patjetër që ata do të mbështeteshin te kontigjenti i të ikurve, kur vendi po çlirohej: anëtarë dhe krerët kryesorë të organizatave nacionaliste si Balli Kombëtar, Mbretërorët e Legaliteti, kundërshtarë me forcat që drejtonte PKS, tek ish pushtetarët e periudhës së okupacionit, te bashkëpunëtorët me okupatorin (kolaboracionistët), tek oficerët e rangjeve të larta të ushtrisë të vjetër e të arratisurit si kriminelë që kërkonin

t'u shmangeshin ndëshkimeve të sistemit të ri, të pakënaqur nga Nacional - Çlirimtarja etj. Këta, mes mosdakordësirave, pikëpamjeve të ndryshme, doktrinave të kundërta, luftës për parësi, inateve të vjetra, sherreve të mbartura, dëshpërimet e deri meskineteteve, u grumbulluan nëpër kampe të ndryshme, kryesisht në Itali, Maltë e Greqi fillimisht, e më pas në Jugosllavi, deri edhe në Gjermani, siç ishte rasti i Kompanisë "Albanian Labor Army Service 4000" (ishin 93 Qendra agjenturore), dhe nisën përgatitjet intensive nën drejtimin e instruktorëve të sprovuar. Ishin kryesisht disa grupime; "Lëvizja e Legalitetit", "Balli Kombëtar", "Blloku Kombëtar Independent", "Partia Agrare", "Lidhje e Prizrenit" dhe QEVA (Qindriqi Epitropi Vorioepiritikon Agona), që vështirë t'i vije në emërues të përbashkët. Pa tjetër që kishte mes tyre dhe idealistë dhe intelektualë të vërtetë. Të gjitha këto, Autori, Prof. Koçollari na i paraqet me saktësinë më të madhe, duke na dhënë edhe imtësira të karakterit doktrinar, psikologjik, kulturor, e deri konsideratat e të huajve rreth kësaj përçarjeje tipike shqiptare. Nuk ishte e lehtë të punohe me këtë ramasis (grumbull pa formë), por instruktorët me eksperiencë ia dolën që më së shumti, jo vetëm t'i stërvisin me sukses ata në ato drejtime që kërkonin veprimtaria klandestine e spiunazhit, por edhe t'i bindin që t'i hynin rrezikut, me besimin se së shpejti objektivat do të arriheshin dhe do të mjaftonte shkëndija që do të ndiznin ata, dhe këtu flaka e revoltës do të kthente gjithçka përmbys. Mirëpo, duhet pranuar se rreziku që vinte prej tyre, qoftë edhe si rrjedhojë e mos njohjes së realitetit nga ata që i drejtonin, që më së shumti që edhe një farë naiviteti, ishte jo i vogël për atë që Shqipëria e re po ndërtonte. Qeveria e komuniste, për hir të së vërtetës, gëzonte autoritetin e nevojshëm, besimin dhe përkrahjen e gjerë të popullit. Kështu, që kjo ia lehtësonte veprimtarinë kundërgoditëse sigurimit të shtetit, i cili në sekretin më të madh, angazhoi një grup oficerësh mjaft të kualifikuar, ku u përfshinë kuadro si Kadri Hazbiu, Pilo Shanto, Asim Aliko, Hekuran Pobrati, Mark Dodani, Fejzo Kasimati, Gjon Banushi e Miti Teneqexhiu me shokë. Është folur gjatë, se përfundimi me sukses të plotë i aksionit të tyre, të infiltruar brenda Organizatës Fronti i Rezistencës, që çoi në asgjësimin, kapjen apo dorëzimin e dhjetra e dhjetra bandave, ka qenë rezultat i informacioneve të agentit britanik që kaloi te shërbimi i fshehtë sovjetik, Kim Filbit. Por këtë legjendë, me fakte, pohime dhe dokumente të pakontestueshme,

Irakli Koçollari e hedh poshtë, duke vërtetuar se e gjithë kjo histori është vepër e vetë shqiptarëve. Ai edhe kronologjikisht na bind se nuk kishte sesi të çonte në këtë sukses kundër shërbimeve të fshehta të disa vendeve armike, që thuajse përherë i kishin bashkërenduar veprimet diversioniste, që nga ato fletushkat propagandistike, emisionet radiofonike e deri te hedhja nga toka, ajri e deti i bandave diversioniste, një raport i vetëm i Kim Filbit i datës 23 shtator 1949. Madje, ai i referohet edhe vetë Filbit që te libri i tij "My silent war", pra "Lufta ime e heshtur", e pranon se nuk ka pasur mundësi të luajë ndonjë rol, as ai dhe as vetë shërbimi i fshehtë sovjetik, KGB - ja. Dhe më mirë se çdo argument, kjo kuptohet qartazi nga deklaratimet në librat e shkruar të sa e sa zbuluesve amerikanë, britanikë etj. që ky autor citon. Dhe si për ta mbyllur këtë kapitull, në libër janë trajtuar me korrektesën dhe vërtetësinë më të madhe, dy operacionet, ku shërbimi ynë sekret shkëlqeu me plot kuptimin e fjalës, ai i quajtur "Buza e Bredhit" dhe "Liqeni i Vajkalit". Nuk ishin pak, por plot gjashtëmbëdhjetë muaj, pra nga maji i vitit 1952 deri në dhjetor të vitit 1953, kur faqeza, sigurimi i shtetit i vuri në lojë shërbimet e fshehta të huaja, me anën e radiogrameve, ku u përfshinë diversantët e kapur dhe të vënë në shërbim, si Et'hem Çako, Zenel Shehu, Halil Branica, Tahir Preçi etj. radiolojë që me të drejtë u quajt "një betejë mes Davidit e Goliathit". Ishte zgjuarsia, trimëria, sakrificat e panumërta të oficerëve shqiptarë që çuan në kapjen e kriminelëve të rrezikshëm si Hamit Matjani etj. i cili në gjyqin e datës 15 prill 1954 e vazhdim, te Kinemaja e Brigadave, do t'i rendiste me gojën e tij vrasjet e panumërta të të pafajshmëve, vetëm e vetëm për të ngjallur panik e pasiguri në popull.

Humbjet janë pranuar nga vetë organizatorët e këtyre operacioneve që kishin shkelur haptazi ligjet e të drejtës ndërkombëtare. Kështu fjala vjen shefi i agjenturistëve amerikanë Ricardson do të pohonte se "Duhet pranuar se viktimat dhe zhgënjimet tona për këtë sezon operacionesh kanë qenë të konsiderueshme... Ne jemi përpjekur t'u kundërvihemi masave në rritje të ndërmarra nga forcat e Sigurimit shqiptar, përmes infiltrimëve të agjentëve të një kalibri të lartë dhe trajnimeve cilësore të agjentëve tanë... Por, ne duhet të pranojmë se çmimi i asaj që ne gatujmë në Shqipëri, është shumë i lartë". Nga ana tjetër, autori i këtij libri të rrallë, jep plot fakte, se kjo veprimtari nuk

Vijon në faqen 13

OPINION

Shqipëria nuk ka nevojë vetëm për një politikë që fiton zgjedhje, por për një politikë që ndërton shtet

KUR KARAKTERI TEJKALON PUSHTETIN

• *Shqipëria ka nevojë jo thjesht për njerëz me ambicie, por për njerëz me karakter. Pushteti nuk fitohet për të poshtëruar tjetrin, por për ti shërbyer kombit. Shteti ndërtohet jo mbi arrogancën, por mbi dijen. Kundërshtari politik është bashkëpërgjegjës për fatin e vendit, jo objektiv për t'u shkatërruar*

Dr. Evarist Beqiri

Ishte 8 maj 1965, më shumë se një vit pas vrasjes së John F. Kennedy-t, Dwight D. Eisenhower bëri diçka që sot duket thujtë e paimaginueshme. Ai ishte 74 vjeç, i sëmurë dhe po merrte veten pas infarkt të tretë. Kishte këshilla të qarta mjekësore për të mos udhëtuar. Por, gjithsesi ai vendosi që të shkonte në Boston, në ceremoninë e hedhjes së themeleve të Bibliotekës Kennedy.

Në krah të Jacqueline Kennedy-t, ish-presidenti republikan iu drejtua publikut me disa fjalë që tronditën sallen. Ai foli për guximin e Kennedy-t dhe për përunjësinë e tij. Në një Amerikë ende të përçarë nga politika, Eisenhower foli për karakterin, jo për pushtetin.

“Presidenti Kennedy kishte armën më të fuqishme të çdo fushate politike, kishte Jacqueline Kennedy-n në krah. Por mbi të gjitha, ai kishte një cilësi që unë e admirova thellësisht në bisedat tona të shumta, guximin për të pranuar diçka që nuk e dinte dhe urtësinë për të kërkuar këshilla.” Momentin e bëri edhe më prekës fakti që Eisenhower zbuloi se kishte ruajtur çdo letër që JFK i kishte shkruar, në një koleksion private që ai e quante “Letrat e një Luani të Ri”. Atë ditë, ai ia dhuroi ato Bibliotekës Kennedy. Ai tha se donte që historia ta dinte se miqësia e tyre kishte qenë e vërtetë dhe se politika nuk i kishte ndarë aty ku kishte më shumë rëndësi.

Jacqueline Kennedy ia shtrëngoi dorën Eisenhower-it dhe pëshpëriti disa fjalë që disa persona pranë saj i dëgjuan: “Ai ju quante Ylli i tij Polar, Gjeneral. Kurrë nuk



pushoi së kërkuari udhëzimin tuaj.”

Zëri i Eisenhower-it u drodh kur u përgjigj: “Dhe unë kurrë nuk reshta së besuari tek ai.” Aty ishin dy njerëz nga botë të ndryshme, një Zonjë e Parë e ve dhe një gjeneral republikan në pension. Kjo ngjarje është pasqyrim domethënës i asaj

se çfarë politika mund të jetë dhe asaj se çfarë politika nuk është më sot.

Dy njerëz nga kampe të ndryshme politike, por të bashkuar nën misionin sublim për t'i shërbyer vendit. Dy njerëz që besonin se respekti dhe ndjesia e shërbimit ndaj kombit është më e madh se

egoja personale. Sot kur politika është një sport sharjesh, përjashtimesh dhe denigrimesh, ky moment na kujton se demokracia mbijeton vetëm kur kundërshtari respektohet. Sepse karakteri vlen më shumë se fitorja.

Pikërisht kjo mungon në politikën shqiptare. Në Shqipëri, politika është kthyer prej dekadash në një luftë për asgjësimin e kundërshtarit. Jo debat idesh, por delegitimim personal. Jo përballje vizionesh, por etiketim. Kundërshtari nuk shihet më si alternativë, por si armik. Kjo ka prodhuar një klasë politike që ka humbur ndjeshmërinë ndaj shtetit, institucioneve dhe qytetarit.

Ne kemi ndërtuar një kulturë ku të pranosh se nuk di diçka shihet si dobësi. Të kërkosh këshillë, si paaftësi. Të respektosh kundërshtarin, si tradhti. Pikërisht e kundërta e asaj që prodhon shtet dhe stabilitet.

Shqipëria ka nevojë jo thjesht për njerëz me ambicie, por për njerëz me karakter. Pushteti nuk fitohet për të poshtëruar tjetrin, por për ti shërbyer kombit. Shteti ndërtohet jo mbi arrogancën, por mbi dijen. Kundërshtari politik është bashkëpërgjegjës për fatin e vendit, jo objektiv për t'u shkatërruar.

Historia e Eisenhower-it dhe Kennedy-t, na rikujton një të vërtetë të madhe. Politika ndahet nga karakteri vetëm për kohësisht. Historia i gjykon gjithmonë të dyja bashkë. Shqipëria nuk ka nevojë vetëm për një politikë që fiton zgjedhje, por për një politikë që ndërton shtet. Dhe kjo është Shqipëria për të cilën ia vlen që të luftosh.

*Marrë nga Gazeta Dielli - Faqja Zyrtare

SHQIPËRIA NË VORBULLËN E LUFTËS SË FTOHTË

Vijon nga faqja 12

përfundoi këtu; as grekët, as italianët, as perëndimorët e sidomos jugosllavët me UDB - në e tyre, nuk i ndërprejnë aktivitetet subversive kundër vendit tonë. Po ashtu, të gjithë kuadrot e caktuar për t'u marrë me aksionet kundër rendit në Shqipëri, pra me inicimin, (se këtu, siç e theksova më lart, kishte dhe politikanë shumë të lartë), me përgatitjen, planizimin, ndjekjen, furnizimin, grumbullimin e të dhënave të agentëve që dërgoheshin në territorin shqiptar, në libër dalin me emrat e tyre. Prof. Irakliu na jep edhe statistikat e humbjeve në njerëz nga agentët e ardhur ilegalisht, por nuk le pa përmendur edhe atë që një numër jo i vogël oficerësh shqiptarë të sigurimit dhanë jetën e tyre në këto ndeshje, pjesë e asaj klime që ndër-kombëtarisht quhej “Lufta e Ftohtë”. Dua të theksoj se historianit - autor i këtij libri, ashtu sikurse edhe në të gjithë krijimtarinë e tij përveç kompetencës profesionale dhe dashurisë për atdheun e tij, nuk i mungon edhe talenti artistik, çka bën që e gjithë krijimtaria e tij të përpohet nga lexuesit.

Aq e vërtetë është kjo, sa duke lexuar kapitujt “Buza e Bredhit” dhe sidomos “Liqeni i Vajkalit”, mendoj se duhen botuar në një libër më vete, pasi do të ishin dëshmi kokëforta mbi zgjuarsinë tipike shqiptare, pavarësisht sesi vajti fati i pjesës më të madhe të atyre që burrërisht triumfuan mbi zbulimet e bashkuara të vendeve të huaja, kur vija e demarkacionit mes dy sistemeve ishte e caruaruar në kulm edhe pse zhvillohej si një film pa zë. Ne e njohim edhe anën tjetër të sigurimit komunist të shtetit shqiptar, atë të egrën e të pamëshirshmen me popullin e vet, që na solli dëme të pallogaritshme, por qëllimi i shkruarjes së këtij libri nga ana e Prof. Koçollarit, ka qenë i drejtuar vetëm tek ajo çka derivoj nga furtuna që solli ajo reja e zezë që kaloi mbi Shqipëri, kur e gjithë bota ishte përfshirë në atë që ai e quan “luftë e çuditshme, e dyshimtë, si një makth tronditës, me të tjera imazhe dhe skena, me të tjerë aktorë e sinjale, krejt ndryshe nga ato luftra që kishte parë njerëzimi gjër atëherë!” Dhe më tej, autori vijon: “Ajo luftë do të ishte një lloj paqeje, në xhepat e së cilës fshihesh lufta. Ajo ishte një luftë që ecte

mes udhëve të paqes, pra një luftë pa zhurma lufte. Në fakt ajo ndihej si e tillë dhe ishte pranuar si e tillë nga të gjitha palët ndërluftuese, veçse pas emrit të frikshëm “luftë” ajo kishte marrë një cilësor nga mbrapa: “e ftohtë”.



KRIJIMTARIA

POEZI NGA AGIM BAJRAMI

Rekuiem për stacionin e vjetër të trenit

Matanë kësaj rruge, është stacioni i trenit
(Ai është mbyllur, ka kaq vjet)
Janë shkrirë lokomotivat dhe vagonët e vjetër
Miqte e mi mashiniste, kanë shkuar në kurbet.

Lokomotiva e mëngjesit ka bërë vetëvrasje
Ajo që na zgjonte çdo ditë, në shtatë pa pesë
Unë doja ca kohë që të hapja qerpikët
Pastaj vishesha shpejt, pa përtesë.

Ateherë ish vështirë, të më mbante shtëpia
(Udhëtimet për mua qenë jetë)
Më pëlqenin lokomotivat, vagonët, shpejtesia
Dhe faturinot e bukura, me sytë mbi biletë.

Më vonë frynë ca erëra dhe stuhi marrëzish
(Ne na pushton shpejt marrëzia)
Sirena e mëngjesit u kalb, zuri ndryshk
Dhe bashkë me të dhe udhëtimet e mia.

Tashmë në peron shoh një turmë endacakësh
Që shajnë njëri tjetrin me shprehje banale
Dritëhijet e tyre lëvizin dritareve
Në trajta dhe formë surreale.

Përtej kësaj rruge, është stacioni i vjetër i trenit
Me mure gri, si një mesjetë
Po pret kaq kohë që të ringjallet
Siç presin të vdekurit, nga fryma e shenjtë!

Skulpturë e papërfunduar

Trendafilat mbi flokë s'leshajnë ende aroma
Por sytë e saj janë të ftohtë si acar
Ajo i ngjan një skulpturë të papërfunduar akoma
Braktisur nga mjeshtri, pak kohë më parë

I shmang gjithë njerëzit që ka pranë
Mbështjellë me pyetje dhe kërkësi
Ajo jeton jetën e saj
Dhe s'le në të, të hyjë njeri.

Megjithatë, kjo s'do të thotë
Se ajo s'pret ndonjë trokitje
Kjo mund të ngjasë dikur patjetër
Ndonjë mëngjes, apo mbasdite.

Dikush papritur do trokasë
Tek porta e saj plot ëmbëlsi
Mund të jetë ndonjë çapkën sykaltër
Ose ndonjë djalë me flokë të zinj.

Ajo do të dalë në prag patjetër
Nën dhëmb diçka do mermërisë
Gjithmonë me sy pak mosbesues
Por kurrë të veshur prej besdisë.

Trëndafilat mbi flokë ngjajnë të parritur akoma
I tremb dhe erë më e lehtë
Ato s'leshajnë ende aroma
Por kjo do ndodhë shumë shpejt, shumë shpejt.

Kafe e lënë në mes

Kafe e lënë në mes, në një tryezë të vetmuar
Dhe një bisht cigareje, e ngiyer në rozë,
Ajo që e ka pirë, ka qenë patjetër një grua
Me sy të hutuar, nervozë.

Dikush do ta ketë fyer nga tryeza përballë
Me fjalë që nuk thuhet me gojë
Mes nesh ka kaq njerëz me tru të përdalë
Që unë s'kam dëshirë ti kujtoj.

Një lëmsh i'u ka mbledhur në fyt pakuptuar
Një çast do ketë ndier dhe pak frikë
Filxhani i kafesë i është derdhur në duar
Dhe ajo ka nxituar të ikë.



S'ka dashur ta zgjasë me atë të tip të mallkuar
(Më mirë larg prej njerëzve të tillë)
U ka mbyllur në dhomë si gjithmonë e vetmuar
Me fytyrën e verdhë si dyll.

Në darkë pa dëshirë, do të shtrihet në shtrat
Me hap të dërrmuar, të thyer
E di se pa gjumë do ti shkoj gjithë kjo natë
Me sy drejt tavanit mbërthyer.

Kafe e papirë në një tryeze të vetmuar
Përzier me vrer dhe mërzi
Këtu pak më parë u fye keqas një grua
Ndaj asaj i vjen turp, të më shohë drejt në syl!

Metaforë malli për dallëndyshen e shtëpisë sime

Ende s'kam ndonjë lajm, nga mikja ime e vjetshme
(Dallëndyshja e bukur me krahët e gjata)
Ne rrinim çdo ditë, tre muajt e verës
Dhe na ndante veç nata.

Me ardhjen e vjeshtës, u përgatit për të shkuar
(Atje ku shtegton soji i tyre)
S'ia harroj dot fytyrën, me mjegull mbuluar
Dhe lotin e tharë posht qerpikëve.

Sikur e ndjente që me mua
S'do shihej më, në këtë jetë
Prandaj u nis që pa aguar
Nën qiejt e ndezur nga rrufetë.

I dridhej gjoksi prej trishtimit
Këtë ma tha një miku im
Ka shumë nga ne, që i vret ndarja
Dhe i shndrron befaz në trishtim.

Ende nuk kam lajme nga mikja ime e vjetshme
(Ka mbetur shkretë shtëpizë e saj)
Unë besoj shumë tek malli i zogjve
Prandaj drejt qiellit sytë i mbaj !

Baladë vjeshte

Ti ike atë ditë bashkë me lejkët
(Ende s'kam mësuar ç' të ka ngjarë)
Nuk më le as kohë, të t'përshtëndesja
Ose të të thoja udhë të mbarë.

Dhe të të pëshpërisja lehtë në vesh
Fjalë që veç për ty kisha krijuar
Ne to kisha vënë ca diej të vegjël
Nga ata që ndrijnë ne të aguar.

Ato ty të ngrohnin herë pas here
Sa herë që kish erë dhe acar

Mua s'më pëlqejnë aspak magjitë
Po për ty u bëra magjistar.

Tashmë që ti po shkosh nën qiejt të vretur
Ajri nga vetmia mund të plasë
Edhe unë i dashuroj lejkët
Po nuk bëj si ti, ti ndjek nga pas.

Ti ike atë ditë bashkë së bashku me verën
Gjethet nëpër degë ende s'qenë tharë
Unë e di, që ti nuk e do vjeshtën
Por të paktë të prisje shiun e pare.

Vetëm pashë traqetin tek largohet
Mbushur plot me pengje dhe udhëtarë
Lejkët i kthen në pranverë
Ta bëjnë të qesh ajrin e ngrirë
Nuk do ish keq sikur të vije
Do ish shumë mirë, do ish shumë mire.

Ullinj në jug

Me njëri tjetrin përqaftuar
Dhe pakëz mjegull lartë në maj
Stuhia e fundit sa ka shkuar
Duke lënë pas dhunën e saj.

Askush s'më thotë se kur janë mbjellur
(Në këtë fshat s'ka më njeri)
Ca zëra thonë se kanë mbirë vetë
Bashkë me shkëmbinjtë të bëhen një.

I'u janë kërrusur degët shekullore
Një pjesë e trungjeve i'u janë çarë
Netëve një erë me ta fërkohe
Dhe i'a merr këngës me të qarë.

Megjithatë çdo mars blerojnë
I mbushin degët plot përplot
Me çdo udhëtar llafe ndërrojnë
Dhe shpesh nga sytë, fshijnë ndonjë lot.

Në mënd i'u vijnë kaq data e ngjarje
Heronj të lashtë dhe të rinj
Kush pati fatin t'i'u rri afër
Dhe s'mori pak përjetësi.

Një lëng i trashë iu rrjedh nga trungjet
Me grimca diejsh edhe resh
(Të vetmet pemë që s'dijnë të vdesin
Por mbjellin pak epikë mes nesh!

E çmendura e qytetit N.

Ajo vazhdon, të flasë me veten akoma
(Unë s'e dëgjoj, sepse jam larg)
Shikoj vetëm ajrin, që nxjerr ca fluska të vogla
Dhe zhurmën e tingujve përqaftuar.

Gjithmonë del këtu që me rrezën e pare
(Dhe zhduket më pas çdo mbasdite)
Ka shumë si ajo në këtë qytet kaq të madh
Ndaj njerëzve s'iu bën aq përshtypje.

Dikush që se njeh, për një çast ndalon hapat
Më pas ikën shpejt, me nxitim
Nën fytyrën e saj, ngurtësuar nga ankthet
Shikon vetëm hije dhe tym.

S'pranon me asnjë të ndërrojë ndonjë fjalë
(Çdo kureshtar e nervozon)
Para saj honi i jetës, hap gojën ngadalë
Dhe pret ta thithë, shpejt, apo vonë

Shpesh herë nga mërzia, i vjen të thërrasë
Me klithma dhe nota prej vaji
Nuk di pse më ngjan me Kasandrën e lashtë
Që loz mes nesh dramën e saj.

Ajo shfaqet çdo ditë, që me rrezën e parë
(Dhe zhduket në çdo përdim)
Duke u tallur pa fund me fatin e mbrapshtë
Këtë botë, me emrin përçmim!

KULTURA

Brenda tre viteve është shndërruar në promovuesin e vlerave më të mira të kulturës sonë kombëtare

TRASHEGIMIA KULTURORE E MUHURRIT DHE ANSAMBLI “DINA DODA”

- *Grupi Folklorik Artistik “Dine Doda”, i shndërruar tashmë në një institucion interpretues dhe përçues të vlerave më të mira kulturore-artistike, me repertorin e tij mjaft të larmishëm ka luajtur dhe luan rol edukativ për publikun, e veçanërisht për bezin e ri...*

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Si çdo trevë tjetër e Dibrës edhe ajo e Muhurrit ka një trashëgimi të pasur kulturore. Në funksion të evidentimit dhe promovimit të kësaj pasurie të vyer, para tre vitesh u krijua Grupi Folklorik Artistik “Dine Doda”, vepër e studiuesit të mirënjohur dibran Islam Voka, që si themelues padyshim do të ishte kryetari legjitim i saj. Krenar për këtë kontribut evident, Islami pohon një bilanc mjaftë pozitiv, që parasëgjithash konsiston në një punë gjurmuese e hulumtuuese për mbledhjen e mjaft këngëve folklorike të kësaj treve artdashëse, të cilat do të shërbenin si burim i repertorit me mjaft këngë popullore e projektimin e disa valleve të burrave e grave në llojin e vet.

Gjithsesi, Islami të mbetet peng mosrealizimi i valles së brezave me të cilën dy kërcimtarët virtuozë nga Hurdhë Muhurrit, vëllezërit Gani e Hamit Rama, me performancën e shkëlqyer do të magjepsnin teleshikuesit e Festivalit Folklorik Kombëtar të vitit 1983.

RIPËRTËRITJA E TRADITËS...

Në vitet “60 – 70” të shekullit të kaluar, ish - kooperativa Bujqësore e Muhurrit kishte një Ansambël Folklorik që konkuronte denjësisht në festivalet lokale e në rang rrethi. Bashkëkohësit mbajnë mend interpretimet mjeshtërore të këngëve popullore të kësaj treve nga Antike e Naim Berisha, Flutura Lala, Dine Doda, Rifat Kbeji, Shyqyrie Mikli, Fadi Doda, Agim Berisha, Farie Sula, Mejreme Çiku etj, meloditë e këndshme të grupit të çiftelive nën drejtimin e Sadik Didës, e virtuoze të cilin luante në koncerte e festivale Hysen Mani nga fshati Shqath, me fyell e kavall.

Po ashtu valltarët Nezir, Nazmi, Gani e Hamit Rama, Hysni Tanushi etj, me performancën e tyre të shkëlqyer në kërcimin e valles dyshe muhurrike e asaj të brezave ia rrisnin prestigjin grupit folklorik të Muhurrit që asokohe drejtohej nga mësuesi i pasionuar, i paharruari Rexhep Hoxha.

Këtë traditë të pasur të atyre viteve po e ripërtërin dhe ngre në nivele të reja bashkëkohore Grupi Folklorik Artistik “Dine Doda” që drejtohet me përkushtin, talent, kompetencë dhe profesionalizëm nga Islam Voka. Nën drejtimin e tij, ky grup performoi me mjeshtri të rrallë artistike në një manifestim të madh kulturor në qytetin e Peshkopisë për rreth 15 minuta me valle, 4 lodra e 3 curle e klarinetë përgjatë bulevardit të blirëve të këtij qyteti e deri tek Pallati i Kulturës, ku u organizua një valle e madhe masive edhe me të pranishmit. Më pas, në qendër të Muhurrit u dha shfaqje e madhe magjepsëse me datë 23 maj 2023 në oborrin fantastik të lokalit të Mustafë Miklit, ku u dhanë falas pije freskuese për të gjithë të pranishmit, e më pas u shtrua një drekë me kryefamiljarët e 7 fshatrave të Muhurrit.

Me datë 2 gusht 2023, një pjesë e Grupit dha një koncert të bukur para artëdashësve të Malishevës e që u mirëprit mjaft mirë prej tyre. Po ashtu në Trime të Kosovës, duke ju rezervuar një pritje madhështore dhe duke u nderuar dhe me Çmimin e Mirënjohjes së Festivalit nga i Madhi Jakup Krasniqi i Malishevës e Komuna, e në fund shtruan një darkë me Grupin



“Dine Doda”.

PAK PËR REPERTORIN DHE INTERPRETUESIT

Në repertorin e Grupit Folklorik Artistik “Dine Doda” spikasin shumë këngët e dasmave që këndoheshin kryesisht në të gjitha katundet e Muhurrit në vite. Drejtuesi I. Voka si mbledhës i tyre thotë se mjaft të bukura ishin këngët që la trashëgimi e moshuara Nilkë Çiku nga Shqathi, e këngë të tjera të cilat u përmbledhën si, këngë dasme në tre potpuri të ndryshme, që u kënduan ashtu siç këndohej në vite në Muhurr. Sipas tij ato u interpretuan mjaft bukur nga Diçe Mani në dy potpuri, Bledar Kaca e Afërdita Lala në një potpuri tjetër si këngëtarë të ftuar, ndërsa këngët e kurbetit u kënduan mjaft bukur nga Diçe, Burbuçe Çuni e Ermira Qoku.

“Këngë për Muhurrin” e këngë dashurie e lirike u kënduan bukur po nga Afërdita (e ftuar), Buçja, Anila e Ermira Qoku, pa harruar këngët e bukura që kënduan Naim e Agim Berisha bashkë me Ermirën e Afërditën në katër këngë duet, apo kënga duet e kënduar nga Avni Xhani e Buçja, ku si përfundim triumfuan shumë duete këngësh mjaft të bukura e admiruese”, pohon Islami.

Ai konfirmon përpjekjet e shumta, madje duke kërkuar dhe koreografë nga qyteti e kështu realizuan tre valle, nga këto dy grash që u interpretuan nga grupi i vajzave të shkollës Mesme të Muhurrit e një valle burrash katërshe, ku vlen të përmendet valltari i ndërjerë e pasionant Albiond Loshja. Me performancën e shkëlqyer, valltarët e këtij grupi ngritën peshë zemrat e artëdashësve të shumtë.

Këngë trimërie u interpretuan bukur nga Agim Berisha e Abaz Loshja të cilat patën një jehonë të madhe. Mjaft e admiruar nga të pranishmit ishte dhe kënga e trimërisë “Kësulëbardhë dibrani” e cila u mirëprit mjaft mirë nga dëgjuesit.

Në bilancin e këtij grupi folklorik artistik, të

dëgjuar tashmë, Islam Voka evidenton ndihmesën e madhe për orkestrimin e këngëve e valleve nga Studio e Vllëzrit Jashar e Idajet Sejdiu nga Tetova. Së fundi ata shkëlqyen bashkë me Diçe Manin në një duet që mbetet hymn si këngë patriotike me titull “Tokat tona të bashkohen”, me tekst nga Islam Voka, tekst mjaft kuptimplotë e aktual për ditët e sotme, e cila është mirëpritur në të gjitha trojet shqiptare brenda e jashtë vendit.

Si përfundim u realizuan 16 këngë të reja e 7 këngë të Muhurrit, por të dëguara e tre valle, (në përgjithësi tekstet e këngëve ishin të poetit të këngës Islam Voka).

“Vitet 2021-2022 do të mbahen mend si vitet më të vështira e të zeza pasi vendin e pushtoi epidemia e Covid - 19, ku na solli mjaft vështirësi e pengesa sidomos në udhëtimet për në Tetovë me amatorët, pasi patëm vështirësi për çmimet e larta të udhëtimit e pengesat tjera mjekësore, por u përballua me sukses”, thotë Islami. Gjithsesi ai vlerëson kompletimin e veshjeve me kostume popullore, si të krahinës së Muhurrit, me të cilat u kompletuan 15 palë kostume popullore për burra e 10 palë kostume popullore për gra, si dhe kompletimin e grupit të vajzave shoqëruese të këngëve për 6 vajzat.

Vlen të përmendet se të gjitha shpenzimet u përballuan nga vetë themeluesi e drejtuesi i grupit Islam Voka me një vlerë prej 15.6 milion lek të vjetra, e nga Petrit Doda me një vlerë 12.7 milion lek të vjetra. Në festat e fundvitit 2025 ishte e ftuar dhe këngëtarja Diçe Mani nga Ansambli “Kuvendi” i Zall Dardhës, e cila u duartrokoi nxehtësisht nga qindra pjesëmarrësit në këtë koncert festiv, për interpretimin e këngës së re me titull “Mall për vendlindjen”, shfaqje e cila u dha në Pallatin e Kulturës në Kamëz më 27 dhjetor.

Grupi Folklorik i Muhurrit përgatitet të japë dhe një shfaqje këtë vit në Festën e përvitshme të Shënkollit në Prati të Selishtës ku do të debutojnë me sukses një të dielë nga data 17-20 maj 2026.

LEGJITIMI I EMRIT TË GRUPI FOLKLORIK ARTISTIK “DINE DODA”

Para tre vitesh, para se të legjitimohej me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, pati mendime të ndryshme për emërtimin e grupit. Kjo sepse, treva e Muhurrit ka nxjerrë personalitete të njohura në fushën e arsimit e kulturës, të njohura deri në shkallë kombëtare.

Gjithsesi, nënshkruesit e akteve të themelimit u dakordësuan tek emri i Dine Dodës. Sepse Ai ishte mjeshtër i interpretimit të rapsodive popullore e i kërcimit të valleve tradicionale të zonës së Muhurrit në festivalet zonale, e po i tillë do të shfaqej edhe

(Vijon në faqen 16)



AKTUALITET

Ministri Vengu inspekton Batalionin e Emergjencave Civile në Mengël: Pol sigurie dhe qendër formimi për mbështetjen e komuniteteve

Mbështetje konkrete për komunitetet në raste emergjencash

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së Elbasanit Gledian Llatja inspektoi mjediset e repartit të Batalionit të Emergjencave Civile në Mengël të Elbasanit, një nga bazat me përdorim të dyfishtë, që po forcohen si pjesë e rrjetit kombëtar të sigurisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore.

Gjatë inspektimit, ministri Vengu theksoi se Mengeli është pjesë integrale e rrjetit të bazave që synohet të bëhen gjithnjë e më funksionale, me kapacitete të shtuara njerëzore dhe logjistike, duke përbushur njëkohësisht nevojat ushtarake dhe ato të emergjencave civile. Sipas tij, kjo qasje garanton rritjen e kapaciteteve luftarake, por edhe mbështetje konkrete për komunitetet në raste emergjencash.

Ministri nënvizoi se përmes rekrutimeve intensive dhe investimeve në infrastrukturë, reparte të vjetra po rijetëzohen dhe po shndërrohen në pika kyçe mbështetëse për menaxhimin e emergjencave, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta për bashkitë dhe qarqet përreth.



Efektivët e Mengelit, tha ai, kanë qenë të angazhuar në të gjithë vendin, përfshirë edhe në përmbytjet e fundit, dhe do të vijojnë të jenë në vijën e parë të reagimit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua përfundimit të infrastrukturës mbështetëse dhe pa-

jisjes së repartit me mjete të reja, të cilat pritet të mbërrijnë gjatë pranverës, duke forcuar flotën operacionale të bazës përmes industrisë ushtarake. Mengeli, për shkak të pozicionimit strategjik në Korridorin VIII është përzgjedhur si një bazë prioritare për investime, duke shërbyer si korridor sigurie dhe logjistik, si dhe si kapacitet prites për trupat e NATO-s gjatë dislokimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta. Gjatë takimit me efektivët, ministri i Mbrojtjes shprehu mirënjohje për angazhimin e tyre në misionet që shpesh shkojnë përtej detyrave klasike ushtarake, veçanërisht në përbalimin e emergjencave civile. Ai theksoi angazhimin e institucionit për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe punës në repart, përfshirë akomodimin, ushqimin dhe pajisjet, duke e konsideruar Mengelin si një prioritet investimesh për vitin në vijim.

Ministri Vengu vlerësoi gjithashtu bashkëpunimin me Bashkinë e Elbasanit, duke theksuar se koordinimi mes Forcave të Armatosura dhe pushtetit vendor është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për reagimin efektiv ndaj situatave të emergjencës.

TRASHEGIMIA KULTURORE E MUHURRIT DHE ANSAMBLI “DINA DODA”

(Vijon nga faqja 15)

në dasma e fejesa, duke ua shtuar atyre bukurinë e gjallërinë. Talentin, zgjuasinë dhe fisnikërinë e tij, Dine Doda i ka shfaqur edhe në jetën shoqërore. Në raste dasmash e gëzimesh të tjera familjare, por edhe në raste fatkeqësive të fisit e të miqve të shumtë, jo vetëm në Muhurr por në gjithë Dibrën, ku ai do të merrte rolin e drejtuesit e të organizuesit, sipas zakonëve të vendit. Gjithnjë në koherencë me realitetin e atyre ngjarjeve do të evidentohet si njeriu që i zinte vend fjalës dhe i kishte dukë puna.

Siç shkruan Sami Doda në librin e tij: “Në kërkim të jetës” (faqe 90-91), “Dine Doda ishte i pranishëm dhe i ftuar kudo në raste gëzimesh në fshat e në zonë, sepse i kishte lezet muhabeti, kënga dhe vallja. Ai dinte të



përdorte me vend e me kulturë alegorinë dibrane. Pasi i kënaqte të pranishmit me shaka e muhabet, kapte çiftelinë dhe këndonte si një rapsod i vërtetë këngë tradicionale të folklorit të zonës. Pastaj linte çiftelinë e hynte në valle duke ia shtuar bukurinë gëzimit familjar...” Bashkëkohësit muhurrakë e mbajnë mend kur si Përgjegjës i degës së Tregtisë Muhurr, në pritjen që i organizuan patriarkut të letrave shqipe Dritëro Agolli më 1981, Dine Doda shfaqti jo vetëm zgjuarsinë e talentin e tij në rrëfimin e ngjarjeve e situatave, por edhe formimin e tij kulturor nëpërmjet leximit të librave të shumtë (nuk kishte lënë asnjë libër të Dritëro Agollit pa lexuar). Emri i tij u bë legjendë, ndaj i referohen edhe sot e kësaj dite, kur ndonëse ka vite e dekada që ka ikur për në botën e përtejme, në bisedat mes miqsh, shpesh thuhet “Siç ka thënë Dine Doda...”!

KUSH ËSHTË ISLAM VOKA, THEMELUESI DHE DREJTUESI I GRUPIT

Grupi Folklorik Artistik “Dine Doda”, i shndërruar tashmë në një institucion interpretues dhe përcues të vlerave më të mira kulturore-artistike, me repertorin e tij mjaft të larmishëm ka luajtur dhe luan rol edukativ për publikun, e veçanërisht

për bezin e ri.

Dhe nëse ky grup është bërë i njohur për mijëra artdashës brenda e jashtë vendit, kjo i dedikohet parasëgjithash një emri të spikatur. Ai është poeti e studjuesi skurpuloz Islam Voka, themelues dhe drejtues i tij, i mirënjohur për përkushtimin, shpirtin artistik dhe talentin që ka shpalosur edhe si mbledhës dhe inskenues i valleve tradicionale, veshjeve koreografike si dhe melodive të pasura burimore të shumë brezave muhurrakë e më gjerë mbarëdibrane. Kësisoj Grupi Folklorik Artistik “Dine Doda” është promovuesi i vlerave më të mira të kulturës sonë kombëtare, të cilat synon t'i pasurojë më tej në festivalet e takimet lokale, kombëtare e ndërkombëtare gjatë vitit 2026 të saponisur në start të mbarë.

Islam Voka lindi në Muhurr më 2 Maj 1954. Kreu arsimin e mesëm bujqësor me bursë në Peshkopinë në vitin 1973. Pas diplomimit si “agronom i mesëm” punoi për gjashtë vite me përkushtim si agronom në kooperativën bujqësore Muhurr, duke u bërë i pari model në shkallë rrethi për studimin agropedologjik të tokave e skicimin në harta, sistemimin me tarraca në shumë fshatra ku gjurmët duken dhe sot, si dhe drenazhimin e tokave.

Në vlerësim të talentit të tij si piktor, si mbledhës i folklorit dhe i përkushtuar ndaj punës me librin, në vitin 1983 e emërojnë metodist të Shtëpisë së Kulturës Muhurr. Në këtë funksion realizoi vepra me nivel të lartë figurativ e propagandistik, si dhe disa kompozime pllakatësh me vlerë (sidomos ato me temë ga luftrat e popullit shqiptar për liri e pavarësi). Në këtë fushë ai konkuronte denjësisht edhe piktorët profesionistë të institucioneve kulturore në qytetin e Peshkopisë.

Në vitin 1986 kreu edhe kursin njëvjeçar pranë Shtëpisë Qëndrore të Krijimtarisë Popullore në Tiranë, ku mori dëshminë përkatëse.

Falë përvojës së tij, por dhe përgatitjes profe-



sionale si metodist kulture, me mbështetjen e drejtorit të shkollës Baftjar Gazidede, të Hazbie Çikut e Fadil Dodës punoi për gjallërimin e jetës kulturore-artistike në Muhurr, ku në festivalet lokale e kombëtare u morën disa çmime dhe vlerësime artistike.

Si të tillë mund të përmendim çmimin për vallen katërshe të grave të Muhurrit, për potpurinë e këngëve të dasmës, kënduar nga Fidaie Bushi dhe grupi; për vallen dyshe të burrave të kërcyer nga vëllezërit Gani e Hamit Rama, për këngën e dy rapsodëve të talentuar Fadil Doda e Agim Berisha, këngët e kënduara nga Antike Berisha, Burbuçe Çuni, Mimoza Hoxha etj.

Një kontribut shumë të vlefshëm dha Islam Voka në ngritjen e bibliotekës me afro 130 mijë tituj librash, të sistemuara model, me skeda e me rafta. Madje kjo punë e shkëlqyer, në vitin 1986 u përgjithësua në shkallë rrethi, sa që erdhën në Muhurr drejtues e veprimtarë të kulturës me 10 autobuzë për të njohur përvojën e tij në këtë drejtim.

Dhe ajo që ia rriti vlerën në këtë fushë Islam Vokës që kontributi i tij në ngritjen e një muzeu bashkëkohor në Muhurr në vitin 1992, së bashku me Besnik Këbejin, Dine Sinën e Baftjar Gazidede, një muze me mjaft vlera historike, kulturore e etnografike të gjinive të ndryshme.

Prirjet e tij krijuese në letërsi, Islam Voka i dëshmoi me tekstin e këngës për Dine Hoxhën, me b/autor R. Këbejin, kënduar nga Can Budi më 1994.

Pas punës 13-vjeçare në shtëpinë e kulturës, afro 13 vite të tjera punoi si mësues në Hurdhë Muhurr, Muhurr, Sharakan e Vajmëdhej ku u dallua për metodën e tij të mësimdhënies për nxënësit të moshave e niveleve të ndryshme, deri sa doli në pension.

Në fushën e krijimtarisë artistike ai njihet si poet i këngës dhe piktor mjaft i talentuar. Prirjet në këtë fushë i shfaqti që kur ishte nxënësi në shkollën 8-vjeçare e të mesme, por veçanërisht shkëlqeu në vitet e mëvonshme.

Duke ndjekur rrugën e krijimtarisë, si piktor shëtitës në të gjitha fshatrat e zonës së Muhurrit, u njoh jo vetëm me bukuritë e natyrës, por edhe me temat historike të luftës për liri e pavarësi. Gjatë kësaj kohe ai realizoi një seri peisazhesh dhe galeri portretesh me tipa e karaktere lakmuese që rrallë i gjen. Pasioni pas peisazheve dhe portreteve ndikoi shumë në ngritjen e tij profesionale.

Gjatë kohës që ishte metodist në Shtëpinë e Kulturës ngriti kursin e vizatimit me nxënësit me prirje piktore. Edhe tani në pension, nuk i ndahet punës së tij krijuese në pikturë, si edhe me kameran e krijimin e videoklipeve interesantë.

Aktualisht ai drejton me talent e përkushtim të rrallë një nga grupet artistike më me emër në Dibër, e pse jo në gjithë Shqipërinë.